


# DRAMA NË KLASË

TË MËSUARIT PËRMES IMAGJINATËS

SHKËLZEN BERISHA

SONILA KAPIDANI

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Në partneritet me:



Zbatuar nga:



## DRAMA NË KLASË: TË MËSUARIT PËRMES IMAGJINATËS

Ky publikim është prodhuar nga projekti "Aftësi për Punë" (S4J) nën mbikqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Materiali u përgatit nga Msc. Shkëlzen Berisha dhe Msc. Sonila Kapidani është pjesë e një nisme pilot "Pedagogjia Teatrore - Drama në Klasë - Të mësuarit përmes imagjinatës", ideuar dhe realizuar nga Sonila Kapidani dhe Shkëlzen Berisha.

### Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

**Shënim:** Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit "Aftësi për Punë" (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

### AFTËSI PËR PUNË S4J

- 📍 Rruga Skënderbej, Vila nr. 49  
Tirana, Albania, P.O. Box 2891
- ☎ +355 42 231 850
- ✉ al.info@swisscontact.org
- 🌐 www.skillsforjobs.al

# PËRMBAJTJA

## 06 Hyrje

## 14 PJESA E PARË

### 16 Njohuri mbi dramën në edukim dhe teknikat e punës

- 16 Mendime nga mësimdhënësit në trajnim
- 19 Po çfarë është drama në edukim?
- 24 Çfarë sugjeron korniza kurrikulare për dramën?
- 25 Si mund të ndihmojë drama në klasë nxënësit përkundrejt të mësuarit?
- 30 Cilat janë teknikat që mund të përdoren?

## 34 PJESA E DYTË

### 36 Sfida të reja, njohuri të reja

- 36 Të krijosh mundësi për përdorimin e dramës
- 38 Përgatitja e mësimdhënësit

## 46 Përmbllje

## 48 Bibliografia

### 50 Shtojcë 1. Teknikat e dramës në edukim

### 55 Shtojcë 2. Përgatitja e mësimdhënësit: shembull planifikim periodik

### 56 Shtojcë 3. Tre shembuj të detajuar lëndor me material të pasur dhe aktivitete



# KUSH JANË AUTORËT

## Shkëlzen Berisha

Regjisor, Aktor, Praktikues i Dramës dhe Teatrit në Edukim, Përkthyes dhe Dramaturg. Është diplomuar në Universitetin e Tetovës për aktrim në Fakultetin e Arteve Skenike në vitin 2004 dhe ka kryer studimet Master Shkencor për Regji Teatri dhe Spektakli në UA- Tiranë.

Që nga viti 2002, ka punuar në shumë projekte teatrore e artistike si aktor, përkthyes, regjisor dhe më e rëndësishmja si praktikues i "Dramës dhe Teatrit në Edukim" si metodologji edukative për fëmijë dhe të rinj në Kosovë e Britani të Madhe. Në vitin 2003, atij i bëhet ftesa në një konferencë drame në Birmingham, ku ndërton bashkëpunime si aktor profesionist i TNE dhe drejtues programesh në shkolla, me institucione teatrore britanike që kanë krijuar dhe realizuar programe të nivelit të lartë profesional mbi Dramën dhe Teatrin në Edukim, në të cilat zhvillon punën e tij profesionale deri në vitin 2009, kur edhe zgjedh të kthehet në Kosovë, për të punuar si Drejtor Artistik në Teatrin e Gjilanit, deri në vitin 2012.

Ka përkthyer mbi 40 pjesë teatrale, (gjysma e së cilave janë vënë në skenë) 3 skenarë filmash, adaptime, përpunime dramatike dhe ka krijuar tekste dramtike për të rritur dhe nxënës. Krahas të sipërpërmendurave, përpjekjet e tij për të përdorur dramën dhe teatrin si medium edukimi për të rinj kanë qenë gjithmonë të vazhdueshme dhe si rrjedhojë, që nga viti 2012, ai vendos të jetoj në Tiranë, ku është bashkëthemelues i organizatës "Qendra e Hulumentit Progresiv", një organizatë e krijuar posaçërisht për prezantimin për herë të parë të metodologjive Drama dhe Teatri në Edukim dhe aty ushtri detyrën e Drejtorit Ekzekutiv. Nën drejtimin e tij kjo organizatë deri tani ka realizuar një numër projektesh të rëndësishme në Shqipëri duke promovuar dhe me synim për të



inkorporuar metodologjitë "Drama dhe Teatri në Edukim" në sistemin edukativ shqiptar. Shkëlzeni është i përkushtuar në dramën dhe teatrin, format, metodologjitë, dhe ndikimin teatror në aspektin social dhe politik. Ndikimi i dramës dhe teatrit në provokimin dhe zhvillimin e imagjinatës njerëzore është pikëqendra e praktikës së tij të vazhdueshme artistike.



Thelbi i punës së tij

Nëse i angazhon  
njerëzit në një  
nivel jetik dhe të  
rëndësishëm, ata  
do të përgjigjen.



## Sonila Kapidani

Ka një përvojë mësimdhënieje në institucione të rëndësishme të arsimit në Shqipëri që nga viti 2002. Në formimin e saj arsimor përfshihet diplomimi në Arte/Piano në Selanik të Greqisë, diplomimi si regjisor teatri në Universitetin e Arteve në Tiranë, kualifikime ndërkombëtare mbi Teatrin dhe Të Folurit në Publik, si dhe studimet master në Antropologjinë e Edukimit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Ndër vite Sonila ka ofruar trajnime të të rinjve dhe profesionistëve në arte, politikë, media dhe shoqëri civile mbi teknikat e të folurit në publik; trajnime të zërit dhe shqiptimit dhe etikën e komunikimit.

Sonila Kapidani gjithashtu është e angazhuar si Regjisore/Aktore dhe drejtuese projektesh teatrore inovative. Puna e saj e mëtutjeshme është dedikuar programeve që kanë në themel edukimin mes Dramës dhe

Teatrit. Ajo së bashku me Shkëlzen Berishën kanë realizuar për herë të parë në Shqipëri programe të Dramës dhe Teatrit në Edukim- formë artistike që ndihmon aktivitetin edukativ. Teatri në Edukim zhvillohet në nivel të thellë vetëm sepse është interaktiv e u jep pjesëmarrëve hapësirë për të shprehur mendimet e njohur botën dhe veten. Këto programe janë realizuar edhe në praktikë më nxënësit në klasa, por edhe në trajnime dhe seminare për mësues në profesion dhe të rinjsh të sapodiplomuar në arte dhe shkenca sociale. Aktualisht drejton Sektorin e Edukimit në Teatrin Metropol.

Sonila Kapidani është autore e librit "Metodika për estetikën e të folurit" (një udhëhapës për të folurit në publik), si dhe e një sërë artikujsh të ndryshëm shkencorë me fokus komunikimin dhe edukimin.



Ajo beson fort se...

Ne – njerëzit, nuk kemi ardhur në këtë  
botë thjesht për të qenë të mirë, por  
për ta ndryshuar.



# HYRJJE

“Jo drama ‘në’ edukim, por drama ‘Si’ edukim”

D. Heathcote

“Është e jashtëzakonshme se çfarë ka zbuluar mendja e njeriut ndër shekuj, por akoma më e mrekullueshme është që ka krijuar shkollën, që të gjitha këto zbulime njerëzit t’i mësojnë brez pas brezi...”

(nga programi Teatri në Edukim – Fjongo e Argjendë, 2012, QHP)



Jemi duke jetuar një periudhë historike plot ndodhi të papritura që na bëjnë të reflektojmë, të befashemi, të përjetojmë frikë, të këmbëngulim të fuqizohemi për t’iu rikthyer jetës me më shumë frymëmarrje, me më shumë dije, me ri-organizime, me më shumë sfida e mundësi. Sistemet e edukimit kanë organizuar punën sipas qasjes bazuar në kompetenca, qasje e cila kërkon ndërthurjen e teorisë me praktikën, duke ndërthurur dijet individuale me ndjeshmërinë ndërmjetore, me aftësitë e komunikimit dhe me vlerat shoqërore.

Procesi i edukimit vazhdimisht ka provuar dhe kaluar nëpër qasje të ndryshme në kërkim të rezultateve që përgatisin njerëz të aftë për të përballuar kërkesat profesionale dhe për një shoqëri më harmonike dhe sa më pranë njerëzores. Reformat arsimore dhe mendimtarët e psikologjisë dhe pedagogjisë kanë sugjeruar në vazhdimësi shkolla të ndryshme mendimi të cilat kanë zhvilluar metodologji të ndryshme për të realizuar programet mësimore. Në arsimin profesional tashmë përveç aftësive të mjeshtërisë, u është dhënë rëndësi edhe aftësive personale të sjelljes dhe personalitetit, që shprehen me termin ‘soft skills’ në udhëzimet nga politikat e edukimit të Komisionit Europian, si mjaft të rëndësishme në marrëdhëniet e punës dhe sugjerimi i këtij udhëhapësi është se Teatri dhe Drama mund të jenë një mjet shumë i rëndësishëm në përmirësimin dhe zhvillimin e këtyre aftësive, duke krijuar në klasa një ambient të sigurt dhe nxitës, ku mësimi mund të bëhet me kureshtje dhe dëshirë.

Në arsimin profesional tashmë përveç aftësive të mjeshtërisë, u është dhënë rëndësi edhe aftësive personale të sjelljes dhe personalitetit që shprehen me termin ‘soft skills’ në udhëzimet nga politikat e edukimit të komisionit europian, si mjaft të rëndësishme në marrëdhëniet e punës dhe sugjerimi i këtij udhëhapësi është se teatri dhe drama mund të jenë një mjet shumë i rëndësishëm në përmirësimin dhe zhvillimin e këtyre aftësive duke krijuar në klasa një ambient të sigurt dhe nxitës, ku mësimi mund të bëhet me kureshtje dhe dëshirë. Kërkesa kryesore e punëdhënësve në këtë botë me ritme shumë të shpejta ndryshimi, është aftësia teknike dhe qëndrueshmëria, pra qëndrimet e përshtatshme për rezultat edhe mjedisor, edhe ekonomik, edhe social. Po me aq rëndësi janë këto kërkesa edhe në jetët personale apo në marrëdhëniet shoqërore. Aftësitë organizative dhe bashkëpunuese kanë marrë një rëndësi shumë të madhe në biznesë dhe industri të ndryshme. Në to përfshihen, komunikimi, puna në grup, lidhshipi, zgjidhja e problemeve. Duke qenë një medium kolektiv, teatri dhe drama i kanë të




gjitha këto mekanizma si pjesë organike të punës. Kjo bën të mundur që pjesëmarrësit të zhvillohen dhe ndryshojnë atë që duket gati si e pamundur, sjelljen dhe zakone të përditshme që mund të jenë pengesë, në një mënyrë integrale dhe të dashur: duke vepruar në një kontekst imagjnativ.

Ky material është realizuar si një udhëhapës për mësimdhënësit e arsimit të mesëm profesional mbi përdorimin praktik të dramës në klasë. Gjithë sugjerimet dhe shembujt praktikë janë të bazuar në punë konkrete të shumë viteve në shkolla të ndryshme, por edhe në praktikën më të fundme mes këtij projekti pilot, një model prezantimi në përdorimin e dramës për lëndën e historisë në shkollën Teknike Ekonomike, Tiranë.



Përgjatë viteve, teoritë e të nxënësve ndryshojnë, evoluojnë, provojnë forma të reja, duke u nisur nga funksionimi i trurit të njeriut dhe njohjes së tij. Aktualisht është mjaft e domosdoshme që për mësimdhënësit truri i nxënësve të perceptohet në funksionin e tij të plotë e jo sipas modeleve të dikurshme që besoj se disa pjesë të veçanta të tij realizonin disa funksione dhe procesi i të nxënësve ishte i prirur të nxisë parçialisht atë. Ndryshime dhe zhvillime të mëdha po ndodhin në çdo nivel të arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Modelet pedagogjike po kërkojnë rrugë të reja për të nxitur më shumë kreativitetin, integrimin dhe mënyrën se si nxënësit mësojnë - me rezultatin që drama, artet dhe krijimtaria kanë nisur të vlerësohen më shumë dhe duket se do të vlerësohen edhe më në të ardhmen, pasi sugjerojnë modele pune që zgjon dëshirën dhe kureshtjen për njohuri të reja.

Nga vitet '90 e këtej, me ndryshimin e sistemit politik janë ndërmarrë një seri transformimesh edhe në sistemin e edukimit nga institucionet përkatëse dhe programet e shkollave kanë pësuar ndryshimet respektive, deri tek ndryshimi i fundit deri më sot hartimi i kornizës kurrikulare sipas kompetencave kyçe të Bashkimit Evropian (2015-2016), që solli kalimin nga qasja bihejvioriste në atë konstruktiviste, me synim arritjen e një procesi edukativ në qendër të të cilit është nxënësi, i cili duhet të zhvillojë aftësitë që do ta bëjnë të aftë të përballojë ndryshimet e shpejta që po sjell jeta. Nevoja për të synuar përmbajtjen dhe të kuptuarit e plotë të dijeve, ka çuar në kërkimin e formave të mësimdhënies që angazhojnë trurin në tërësinë e tij bashkuar edhe emocionet. Në botë që nga vitet '50, nisi të përhapet qasja konjitiviste apo njohëse. Disa nga përfaqësuesit e saj si Piazhe, Bruner, Chomsky, etj. kanë realizuar punime me vlerë të jashtëzakonshme mbi këtë qasje që synon të kuptojë mënyrën se si nxënës njerëzit, kapacitetet individuale dhe kombinimin e përmbajtjeve kuptimore. Nxënësia kuptohet si riorganizim i strukturave njohëse. Kujtesa, njohuria, të menduarit dhe zgjidhja e problemit, janë procese mendore që synohen të shpjegohen. Bihejviorizimi dhe konjitivizmi, janë teori që kanë rezultate të matshme, përkundrazi konstruktivizmit që synon një nxënie me fund të hapur, ku rezultatet nuk janë të njëjta për çdo individ dhe nuk maten. Konstruktivizmi synon nxënien në të cilën mundësitë njohëse janë shumë të mëdha. Piazhe dhe Vigotsky janë dy figurat më përfaqësuese të konstruktivizmit. I pari, ka bërë kërkime lidhur me origjinën e koncepteve kohë, hapësirë, realitet, numër, lëvizje, shpejtësi, origjinën e gjuhës, simbolit, moralit, gjykimit, arsytimit, etj. Ndërsa i dyti, u dedikua ndërtimit të mendimit. Pas tyre dhe të tjerë kërkues mbështetën dhe zhvilluan qasjet konjitive apo njohëse. Për konstruktivistët njohuritë ndërtohen duke vepruar (drama dhe teatri janë veprim), jo duke i marrë si kopje por duke i rindërtuar. Një seri njohurish të reja janë prezantuar si mësimi aktiv, mësimi në distancë, mësimi me projekte, etj.





Të nxënit arrihet duke bërë lidhje zinxhir dhe këto lidhje nuk arrihen në mënyrë mekanike. Nëse do të marrim aspektin biologjik, këto lidhje zinxhirore ndodhin mes neuroneve të cilat marrin hov sa herë njeriu përballet me një përvojë të re. Në aspektin mendor këto lidhje bëhen mes koncepteve të cilat njeriu i lidh mes bashkimit të ideve në dy mënyra:



Duke i mbajtur mend



Duke u bërë i vetëdijshëm për lidhjen mes objekteve dhe veprimeve (këtu drama është mjete i duhur, sepse shtyn për nga gjetja e kuptimeve)

Ndërsa në nivelin social këto lidhje marrin formën e bisedave ndërkohë që njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin dhe ndajnë ide, mendime, përvoja, etj. Nëse këto lidhje ndodhin në mënyrë natyrale, jo mekanike, atëherë të nxënit nuk ngjan i vështirë dhe i padëshirueshëm. Kjo është sfida aspak e thjeshtë e mësimit që t'ia përcjellin dijet nxënësve jo në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra, por në mënyrë natyrale, zinxhirore, me qëllim që të ndërtohet tek ata baza që do të sjellë përgatitje për të përballuar sa më mirë tregun e punës në botën e vërtetë.

Mirëpo, edukimi që arrin nxënie kuptimplotë dhe krijuese nuk i konsideron nxënësit vetëm si spektatorë apo si kuti bankare (nëse do përdornim përcaktimin mbi format e edukimit që Paulo Freire i quante "arsimi bankar", kjo është një marrëdhënie e sundimit në të cilën mësuesi ka njohuri që i depoziton në kokat e objekteve pasive - nxënësit), por edhe si bashkëveprues njëkohësisht (që do të thotë në "arsimin që shtron probleme", që inkurajon nxënësit për t'u bërë aktivë në të menduarit dhe vepruarit mbi botën ku jetojnë). Dhe nëse brezat e rinj nuk përshihen në proces për të dalë në përfundime të përbashkëta me drejtuesin/mësimdhënësin për rëndësinë e dijeve, vlerat e tyre, burimet, arsyet pse është krijuar, do të jetë e vështirë të krijohet një marrëdhënie dobiprurëse dhe zhvillimore në hapësirën e shkollës mes të rinjve dhe të rriturve.



Siç pohon edhe Kieran Eagan, një filozof i rëndësishëm edukimit:

Qëllimi nuk është thjesht për të mësuar faktet dhe aftësitë që mund të riprodhohen kur kërkohet. Qëllimi është që të lidhin faktet dhe aftësitë në kuptimin e tyre më të thellë në përvojën njerëzore.

Kieran Eagan


Gjithë përshkrimin e mësipërm po e përmbledhim në këtë fund të fillimit për të theksuar rëndësinë e përdorimit të kësaj metodologjie në arsimin profesional. Drama në edukim mbështetet në pedagogjinë kritike dhe metodologjinë konstruktive, si një mënyrë e dëshmuar që i sjell pjesëmarrësit në angazhim të drejtëpërdrejtë me përvojat e njohurive që marrin në procesin mësimor. Sidomos në arsimin profesional nevoja e praktikës është domosdoshmëri, ndaj të mësuarit duke bërë është mënyrë që fton për nga angazhimi duke e bërë të mësuarit të dashur për pjesëmarrësit. Kjo metodë u shërben të dyja palëve: edhe mësimitdhënësve, edhe nxënësve, sepse:



Ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale të mësuesve



Kontribuon në fuqizimin e identitetit profesional të tyre



Përmirëson aftësitë e tyre mësimore dhe organizative



Ndihmon jashtëzakonisht shumë në arritjen e qëllimeve mësimore si mësimitdhënësit ashtu edhe nxënësit



Përforcon vetëdijen mbi domosdoshmërinë dhe aftësinë e jashtëzakonshme për të mësuarit gjatë gjithë jetës



Ndihmon nxënësit të zhvillojnë bashkëpunim dhe ndërveprim efektiv brenda dhe jashtë ambientit shkollor

## Qëllimi i këtij udhëhapësi

Të njihet drama në edukim dhe mundësitë e saj, teknikat e punës dhe mënyra bazë përdorimi. Të promovohet rëndësia e dramës në klasat e shkollave profesionale, si një mjet për të motivuar dhe fuqizuar mësimin në fusha të ndryshme të kurrikulës, me prezantim bërthamë lëndën e gjuhës.

Konstruktivizmi është një kuadër referimi që i përgjigjet pyetjes "si i ndërtojnë nxënësit dijet?", pyetje që është përputhur edhe me nxitjen për ta hatuar këtë udhëhapës. Udhëhapësi është krijuar për mësuesit që janë aktualisht në mësimdhënie, por dhe për mësuesit e ardhshëm që do të japin mësim në shkollat profesionale. Qasjet ndaj dramës në edukim që sugjerohen këtu mund të përdoren për çdo grupmoshë duke u përshtatur, pasi do të jenë teknika bërthamë.

Në këtë udhëzim do të ketë njohuri të para për dramën si një lëndë më vete, por edhe si përdorim i fuqishëm për të mësuar lëndë të tjera. E kemi provuar dhe e kanë dëshmuar studiues të ndryshëm dhe shumë mësimdhënës në vende të ndryshme në botë që drama ka një fuqi të jashtëzakonshme për të motivuar nxënësit që të angazhohen në mësim, për të zhvilluar krijimtarinë dhe për të rritur aftësitë individuale dhe shoqërore.






# PJESA E PARË



# NJOHURI MBI DRAMËN NË EDUKIM DHE TEKNIKAT E PUNËS

## Mendime nga mësuesit në trajnim

Mësuesit kanë një rol kryesor në menaxhimin e sjelljes së nxënësve, gjë që nuk është gjithmonë një detyrë e lehtë, veçanërisht kur fëmijët shfaqin sjellje kërcënuese ose të dhunshme e duhen trajtuar me kujdes më të madh. Në një nga punët e bëra me dramën në një shkollë në Britani, një mësues kishte shkruar në një tabelë në klasë:



Ky fakt është diskutuar shpesh në praktika në shkolla të ndryshme, sidomos në takime me mësues që janë të përkushtuar dhe e dinë se, sado vështirë, ata e kanë në dorë që t'i ndryshojnë dijet e jetët e nxënësve për mirë. Ne kemi zhvilluar dy trajnime të nivelit të parë me mësues nga dy shkollat profesionale 'Shkolla Teknike Ekonomike' dhe 'Shkolla Teknike Elektrike 'Gjergj Canco' në të cilat shkëmbyem mendime të ndryshme mbi mundësitë e përdorimit të teknikave të dramës në shkolla, takuam dëshirën për të provuar teknika të reja që do të sillnin përmirësim në klasat e tyre dhe kjo na ka motivuar që ta amortizojmë sa më shumë dyshimin e tyre për përdorimin e dramës në klasë përmes këtij udhëhapësi. Në përfundim të trajnimit dy ditë zhvilluam një reflektim, disa mendime prej të cilave po i prezantojmë në vijim:

**I** **Mësuese I.G.**

'Ndërsa dëshira ime pas trajnimit është të bëj të mundur realizimin e gjithçkaje që mësova në klasat ku zhvilloj mësim, frika ime lidhet me vështirësitë që do të has në realizimin e objektivave. Dhe të dyja bashkë do të më nixsin për të punuar fort për të shfrytëzuar potencialin tim personal dhe aftësitë individuale të nxënësve.'

**Mësuese N.G.**

'Ndërsa dëshira ime pas trajnimit është ndjesi shumë pozitive sepse të hap kujtesën, kureshtjen dhe kënaqësinë për të marrë pjesë herë pas here. Kjo dëshirë mund të jetë realizuar, por akoma lë vend për t'u vazhduar. Frika ime se trajnimi si proces të mos mbetet në letër, por të gjejë zbatim tek nxënësit. Do të desha të ishte më shumë dëshira për ta realizuar. Të dyja se bashku bashkëveprojnë në një pikë dhe të dyja më mbetën më shumë në memorje.'

**E** **Mësues E.GJ.**

'Ndërsa dëshira ime pas trajnimit është të realizoj në klasë me nxënësit teknikat që mësova në këtë trajnim, frika ime është që me nivelin e nxënësve që kemi në shkollë nuk do të jetë e lehtë për t'u realizuar këto teknika. Dhe të dyja bashkë më nxisin që ta provoj.'

**Mësuese D.F.**

'Ndërsa dëshira ime pas trajnimit është rritja e përdorimit të teknikave të dramës në orët e mësimit, megjithëse frika ime është komplekse e nxitur nga shumë faktorë. Të dyja bashkë më ngacmojnë mendimin: sa e vështirë të jesh mësues i mirë.'

**D** **Mësues D.K.**

'Dëshira ime pas trajnimit është që ta aplikoj gjatë orëve të mësimit formën e mësimit si lojë, sepse bëhet më argëtuese dhe mbahet mend gjatë. Frika ime është se gjatë zhvillimit të lojës mund të ketë debate të forta kundërshtuese ndërmjet tyre, dhe minutat nuk mjaftojnë për të realizuar orën mësimore.'

**Mësuese A.B.**

'Ndërsa dëshira ime pas është marrja e metodave të reja për dhënie të informacionit për nxënësit, frika ime është tek mundësitë e zhvillimit në maksimum të këtyre metodave në ambientet e klasës. Të dyja bashkë më shtojnë ta provoj.'



### Mësuese G.S.

Dëshira ime është ta zbatoj praktikisht këtë metodë pune të paktën një herë në javë në cdo klasë. Frika ime është stafi pedagogjik. Shumë mësues janë mjaft të vjetër në teknikën e mësimit dhe kjo teknikë për ta do të ishte risi, por edhe të merrej si keqmenaxhim i klasës nga ana ime (për shkak të zhurmave që mund të prodhohen nga veprimet). Dhe të dyja bashkë më japin pak hezitim, por unë do ta bëj! Faleminderit për kohën produktive që më dhatë!



### Mësuese A.S.

'Ndërsa dëshira ime është të kemi trajnime të tjera për përdorimin në fushën e historisë. Mendoj se ndihmon në komunikimin dhe shkëmbimin e eksperiencave. Frika ime është se kjo metodë nuk është e lehtë për t'u realizuar gjithmonë në një orë mësimi, pasi mendoj se do të më marrë shumë kohë nga ana e nxënësve sepse do t'ju pëlqejë vetëm pjesa e lojës. Dhe të dyja bashkë më nxisin dëshirën për ta provuar, por jo gjithmonë.'



### Mësuese V.C.

'Dëshira ime është të përdor teknikat e sapomësuarat në orën e historisë. Frika ime që nuk do të jetë e lehtë t'i përdor këto teknika ëpr shumë arsye. Dhe të dyja bashkë më nxisin të mendoj për mënyrën e realizimit (mundësinë).



### Mësuese D.SH.

'Ndërsa dëshira ime pas trajnimit u realizu me marrjen e informacioneve të reja e të plota për përdorimin e teknikave të dramës në orët e mësimit për ta bërë më të bukur e më tërheqëse/zbavitëse orën e gjuhës. Prandaj shpesh më vjen në mendje shprehja e popullit 'sa të rrosh, do të mësosh'. Frika ime e fillimit të trajnimit u largua (jo plotësisht). Mendoj se shumë gjëra mund të bëj në klasë me nxënësit e mi. Mund të provoj, po nuk e provova nuk e di fundin. Kush guxon, fiton. Dhe të dyja bashkë me shtojnë drejt së resë në orën e mëimit.



### Mësuese A.P.

'Dëshira ime pas trajnimit është ta provoj me patjetër pedagogjinë teatrore, por frika ime është mbështetja e nxënësve të mi dhe suksesi në të. Dhe të dyja bashkë me motivojnë që shumë shpejt kjo metodologji do të përdoret nga unë.'

## Po çfarë është Drama në Edukim?

Siç e theksuam më lart, zhvillimet e reja nuk e konsiderojnë mësimitdhënësin si transmetues të dijeve, por nxënësit i ndërtojnë dijet rrishtas përmes veprimeve. Nevoja për të synuar përmbajtjen dhe të kuptuarit e plotë të dijeve, ka çuar në kërkimin e formave të mësimitdhënies që angazhojnë trurin në tërësinë e tij bashkuar edhe emocionet. Të gjitha ndryshimet dhe provat kërkojnë kohë dhe durim.

### Drama në edukim

është një formë e të nxënësve të krijuar që:



Të krijojë ndërgjegjësim për veten (mendjen, trupin, zërin) dhe të tjerët (bashkëpunimin dhe kuptimshmëri)



Të rrisë qartësinë dhe kreativitetin në komunikimin e ideve të artikuluar dhe jo të artikuluar



Të thellojë të kuptuarit e sjelljeve njerëzore, motivimin, dallueshmëritë, kulturën dhe historinë

Drama në edukim është një metodë pune që është gjithmonë në kërkim të pyetjeve. Në raport me kurrikulën e re bazuar mbi kompetencat kyçe të Bashkimit Evropian, ajo bën të mundur që procesi i të nxënësve t'i përmbush që të gjitha ato (kompetencat ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare; kompetencën e të mësuarit për të mësuar (learning to learn); sipërmarrjen, aftësinë për të shndërruar idetë në veprime; vetëdijen dhe shprehjen kulturore), mes një veprimtarie sa të pëlqyer nga nxënësit, aq edhe nga mësimitdhënësit (këtyre të fundit u heq nga supet barrën e rëndë të "autoritetit" që pengon për një proces të sigurtë, gjithëpërfshirës dhe pa barriera). Teknikat e metodologjisë Drama në Edukim, bëjnë të mundur asimilimin e temave të ndryshme të programit mësues, jo përmes riprodhimit të njohurive të mësuarit përmendësh, po në një ambient bashkëveprues për të kuptuarit e tyre si përvojë njerëzore.

Drama në Edukim përmbush të gjitha kompetencat kyçe të kurrikulës bërthamë që janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare
- Kompetenca dixhitale



“Në hapësirën e shkollës është dy gjëra bashkë, edhe metodë pune, edhe subjekt lëndor. Si subjekt lëndor përdor elementë dramatikë të ndryshëm si lëvizjen, zërin, përqendrimin, improvizimin dhe lojën në role për të arritur zhvillimin personal të nxënësit. Si metodë ajo përdor lojën në role dhe “të bërit” (veprimin, aktrimin) me qëllim që t’i mësojë nxënësit përmes përvojës. P.sh. nxënësit mund të mësojnë faktet e një ngjarjeje historike, duke e bërë atë. Në shumë shkolla të mesme në Britani, ajo është tashmë si departament në vete. Në shumë shkolla ta arsimit fillor përdoret si metodë për të mësuar një numër lëndësh.”

Redington, 1979

Një nga pionieret e përdorimit të dramës në klasë dhe edukatoët më në zë të shekullit të xx-të, krijuese e metodës ‘Manteli i ekspertit’ (që është një punë më vete dhe do të duhej një tjetër punim për ta shpjeguar), Dorothy Heathcote (1926-2012), e përshkruan dramën si një mundësi për arsim cilësor e jo sasior, si një mjet që krijon volum dhe i bën nxënësit të nxjerrin në pah gjëra që i dinë, por që nuk janë të vetëdijshëm që i dinë:



‘Pra, në duhet t’i aftësojmë mësimdhënësit tanë që të strukturojnë një situatë mësimore të gjallë dhe vepruese se sa ndarje të një informacioni absolut. Duhet t’i aftësojmë që të përdorin ekspertizën e tyre e t’i përballin nxënësit me problemet më parë se t’i takojnë më dijet e mësuesve, të arrijnë tek përgjigjet më shumë se sa të dëgjojnë përfundime.’



Në fjalorin shqip janë këto dy përcaktime për dramë dhe teatër:

## TEAT/ËR, ~RI m.sh

1. Lloj i artit dramatik paraqitja e veprave letrare ose e pjesëve dramatike në skenë nëpërmjet aktorëve; fusha e kësaj veprimtarie artistike. Teatri dramatik. Teatri kombëtar (popullor). Teatri antik. Historia e teatrit shqiptar.
2. Shfaqje e një veprë a e një pjesë dramatike, luajtja e saj nga aktorët; punonjës që merren me përgatitjen dhe me dhënien e shfaqjeve të tilla; institucioni që merret me këtë punë; ndërtesa e këtij institucioni. Teatër veror (i mbyllur). Trupa e teatrit. Aktorët e teatrit. Regjisori i teatrit. Teatër me shumë vende. Ishim në teatër. Shkon rregullisht (shpesh) në teatër.

## DRAM/Ë, ~A f.sh

Gjini e letërsisë artistike që e pasqyron jetën përmes veprimit skenik të personazheve dhe të dialogëve e të monologëve të tyre; lloj i gjinisë dramatike që përfshin vepra të tilla me karakter serioz (ndryshe nga komedia), por jo heroik (ndryshe nga tragjedia); vepër letrare e këtij lloji, zakonisht në prozë; shfaqja e kësaj veprë në skenë.

### Është

Metodë krijuese mësimi

Mëson punë në grup për zgjidhjen e problemeve

Krijon ose ripunon një tekst për nevoja mësimore.

### NUK është

Riprodhim tekstesh

Mundësi për artikulum traumash

Një proces me një drejtues autoritar

Në fakt drama njihet si një dialog i shkruar, por përfshin një gamë të gjerë mundësish brenda klasës. P.sh. për lëndën e gjuhës jep stimuj pozitivë në zhvillimin e gjithëpërfshirjes në procesin e të nxënit dhe kompetencave të të folurit, të dëgjuarit dhe komunikimit.

Mbi të gjitha, drama është një metodë që i angazhon pjesëmarrësit në nivel të thellë në një ambient të sigurt, sepse thelbi i saj është **‘mësoj duke bërë’, por në ‘këpucët e tjetrit’.**

Pra, Drama në Klasë ose Të mësuarit mes Dramës është emri që zakonisht i jepet përdorimit të teknikave të dramës në kurrikulën shkollore, si një metodë mësimore për lëndë të ndryshme, por edhe një lëndë në vetvete. Ajo përdor elemente të ndryshme dramatike dhe vepron si një mjet mësimdhënie me tekste të zgjedhura, ose me tekste të krijuara për nevojat e lëndës. U jep mundësi individëve dhe grupeve të eksplorojnë, formojnë dhe përfaqësojnë idetë, ndjenjat dhe pasojat e tyre në formë simbolike ose dramatike.



GREQISHT

→ ANGLISHT

Theatron

Theatre

Fjala Teatër vjen nga greqishtja e vjetër, ‘theatron’, që ka kuptimin një vend për të parë.

GREQISHT

→ ANGLISHT

Drao

Drama

Fjala Dramë vjen po nga greqishtja e vjetër, ‘drao’, që ka kuptimin veprë.

## Çfarë është dhe nuk është Drama

Pra, siç edhe vihet re në përcaktimet e mësipërme, Teatri dhe Drama janë dy punë të ndryshme me rregull, me ngjashmëri dhe dallime që duhen marrë parasysh kur programon orët mësimore.



### TEATËR

E vendos theksin tek produkti, që është një shfaqje e realizuar sipas disa standarteve të caktuara.

Mbështetet tek individë të cilët kanë aftësi të veçanta apo ‘janë të talentuar’, por edhe kanë interes për aktrimin si profesion.

Ka në themel mjeshtërinë e interpretimit për të nxjerrë në pah përmbajtjen e veprës.

Respekton standardet e krijimit të cilat duhet t’u përmbahesh dhe të cilat do të gjykohen.

### DRAMË KRIJUESE

E vendos theksin në kënaqësinë që të sjell procesi i të mësuarit, krijimtarisë dhe zbulimit të shtigjeve të reja për nevojat e veta.

Mbështetet në parimin se ‘gjithkush mund të jetë aktor’ dhe mund të shprehë ide, ndjenja, mendime, emocione, krijojë dije, të shohë dhe dëgjojë në një proces hulumtimi.

Ka në themel dramën si një mënyrë për të eksploruar tema duke hulumtuar. Nuk është me rëndësi a është apo jo tema me natyrë ‘teatrale’.

Respekton aftësitë individuale për të bërë lidhjet me temën e përzgjedhur.

Ka një proverbë çeke për sistemin kombëtar arsimor që thotë:

**Qaj, Mëso, Kalo Provimet dhe pastaj Harro gjithçka!**

Ne mendojmë se Drama në Edukim ka fuqinë që ta transformojë në:

**Qesh, Luaj, Mëso dhe atë që mësove do ta përdorësh gjithë jetën!**



# Çfarë sugjeron korniza kurrikulare për dramën?

## Arsimi i përgjithshëm:

**Korniza Kurrikulare - Lënda Teatër:** "Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë si lëndë të detyrueshme në shkallën 1, shkallën 2 dhe shkallën 3. (Kurrikula Bërthamë, IZHA)

**Klasa 10: KURRIKULA ME ZGJEDHJE LËNDA: TEATËR:** 'Programi i teatrit, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave ka si qëllim të përforcojë e të zhvillojë më tej njohuritë dhe konceptet për edukimin dhe formimin artistik në teatër, të kuptuarit dhe të vlerësuarit e elementeve teatrore që na rrethojnë, zhvillimin e aftësive interpretuese, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të teatrit shqiptar dhe botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimtari teatrore tradicionale apo skenike, duke manifestuar vlerat e materialeve të interpretueshme kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave teatrore për të krijuar dhe realizuar pjesë të ndryshme të kësaj gjinie, dhënien e kontributit personal në zhvillimet artistike teatrore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.'



# Si mund të ndihmojë drama në klasë nxënësit përkundrejt të mësuarit?



Një nga shqetësimet e mësimeve të mësimdhënësve që morën pjesë në trajnimin dy ditor për të cilin kemi folur më lart, ishte se mos klasa do të arrinte mes lojës në një entuziazëm të tepruar të cilin mësimeve do ta kishin problem për ta menaxhuar. Jemi tërësisht të mendimit se është shqetësim i duhur në sprovat e para të përdorimit të dramës në klasë. Ndaj e shohim të udhës të sqarojmë se nuk bëhet fjalë për një program që do të mbështetet vetëm mbi lojëra dhe idenë se do të jetë një orë mësimi argëtues, sepse kështu nuk do të ketë rezultatet e dëshiruara dhe niveli i arritur me nxënësit do të jetë sipërfaqësor. Mësimeve u duhet të përgatiten për orë të tilla mësimore dhe të kenë ide dhe objektiva shumë të qarta. Vetëm nëse përdoren në kontekstin e duhur, loja dhe metodologjia mund të jenë produktive. Drama në Edukim është një qasje pedagogjike që realizon një proces dialektik, me bazë reflektimet, që arrin asimilimin e njohurive të qëndrueshme mbi paraardhësit nga nxënësit.

Hapi i parë është që nxënësve t' u bëhet e ditur që do të provojnë një mënyrë të re të mësimit mes dramës, se cili do të jetë roli i tyre në dramë dhe se cilat janë aktivitetet që do të zhvillohen. Po ashtu, duke ndërthurur teknika aktoriale ajo i ndihmon fëmijët në zhvillimin fizik, social, emocional, dhe konjitiv (njohës). Është një formë e të nxënësve të krijuar që:



Të krijojë ndërgjegjësim për veten (mendjen, trupin, zërin) dhe të tjerët (bashkëpunimin dhe kuptimshmëri)



Të rrisë qartësinë dhe kreativitetin në komunikimin e ideve të artikuluar dhe jo të artikuluar



Të thellojë të kuptuarit e sjelljeve njerëzore, gjuhën, motivimin, dallueshmëritë, kulturën dhe historinë



Në përdorimin në shkolla të kulturave të ndryshme në botë tashmë drama është e dëshmuar për krijimin e mundësive shumë të pasura dhe të fuqishme në përmirësimin disa aftësive, veçanërisht:



të folurit



të dëgjuarit



diskutimit në grup  
dhe ndërveprimit



kuptimit dhe  
interpretimit të  
teksteve



kuptimit të  
strukturës dhe  
organizimit të  
tekstit




krijimin e teksteve  
të reja

Për më tepër, drama është një burim jashtëzakonisht i efektshëm për:



Drama është një mënyrë e shkëlqyeshme për të bërë mësim të gjalla dhe gjithashtu mund t'u ofrojë nxënësve të të gjitha aftësive një mundësi për t'u përfshirë në aktivitete argëtuese, ndërsa mësojnë në të njëjtën kohë dhe kjo e fundit është në fokusin kryesor. Rasti për të cilin bën fjalë ky punim është përdorimi i dramës për të mësuar gjuhën shqipe.

Përdorimi i dramës në klasë nuk duhet të presupozojë një situatë "ne dhe ata", domethënë një grup aktorësh që luajnë dhe një audiencë pasive. Duhet të përfshihet e gjithë klasa në vendimarrje dhe në proces zbulimi, ndërkohë që eksplorojnë potencialet e domethënies së tekstit/situatës. Teknika e dramës i bëjnë nxënësit të kenë dëshirë të përfshihen në proces dhe të mos ndjehen të gjykuar apo të përjashtuar. Gjithashtu drama i fton mësues dhe nxënës të veprojnë së bashku në mënyrë krijuese dhe në krijimin e një marrëdhënieje të bashkëvepruese.



| Edukimin personal dhe përmirësimin e aftësive ndërpersonale   | Social dhe qytetar  | Estetik   |
|---|---|---|
| Të marrësh iniciativën, të kesh komunikim të qartë verbal dhe jo-verbal, të marrësh vendime, të bëhesh fleksibël, të dish të shkruash raporte, kërkesa, të zhvillosh vetëbesimin, përshtatshmërinë, të aftësohesh në zgjidhjen e problemeve | është në thelb një proces i domethënies kolektive dhe ka shqetësim për eksplorimin e sjelljeve shoqërore dhe vlerave në të cilat një shoqëri mbështetet; promovon përgjegjësinë, empatinë dhe bashkëpunimin jo vetëm të nxënësve me njëri-tjetrin por edhe të nxënësve dhe mësimitdhënëve | duke ndihmuar të mësosh të perceptosh në mënyrë të diferencuar, të krijosh me mjete teatrale, të njohësh konvencionet teatrale, të njohësh dhe përdorësh estetikën e komunikimit – pjesë e së cilës është edhe njohja e vetvetes dhe hapësirës përreth: Trupi/Shprehja; Frymëmarrja/Zëri/Shqiptimi/Hapësira |



# Cilat janë elementët bazë të dramës?

## Gjuha



e folur dhe e gjestikulacionit dhe mimikës dhe trupit në tërësi

## Roli



një herë duke vepruar si dikush tjetër; ose si vetja në një situatë tjetër

## Tregimi



Lidhja zinxhir i ngjarjeve apo imazheve për të krijuar kuptim

Në këtë formë edukimi mes mjeteve artistike, përdoren në mënyrë të thjeshtëzuar edhe elementë të teatrit si: kostumet, scenografia, muzika, rekuizitat, ndriçimi, etj. për ta bërë sa më të pasur përvojën që do të kalojnë nxënësit, të cilët transformohen nëpër role të ndryshme gjatë procesit, si autor, aktor, piktor, këngëtar, regjisor dhe gjithashtu publik. Gjatë procesit mund të përdoren disiplina të tjera apo forma artistike si pantomima, rrëfimet, radio drama, improvizimi, teatri i kukullave, cirku, teatri i maskave, teatri i hijeve, të folurit artistik, dramaturgjia, regjia, radio drama, realizimi i një prezantimi.

Sipas Luke Abot (një nga të diplomuarit e parë me Dorothy Heathcote dhe sot këshillues e trajnues i mësimdhënësve në Britani dhe ndërkombëtarisht) janë tri mënyra me të cilat mësimdhënësit mund të operojnë:

**Ekspressive** – në atë se mësimdhënësit përdorin veten e tyre, sjelljet e tyre, gjuhën e tyre të trupit, e kështu me radhë, si sistemin kryesor të dhënies së sinjaleve për të krijuar një kontekst. Ka raste që edhe individë të tjerë të rritur mund të marrin trajta të tilla. P.sh. të ftuar, mësimdhënës të rinj që bëjnë praktikën, etj.

**Ikonike** – ku mësimdhënësit përdorin forma të vizatuara diagramtike apo fizike (paraprakisht një ore mësimore apo të krijuara me klasën në orën e mëhershme). Me objekte deskriptive dhe burime të tjera të ndryshme të sipërfaqeve, për të vënë në punë dhe krijuar shenja të përshtatshme për hulumtimin e vëzhguar. Për shembull, vizatimi përreth një personi me shumës prodhon një shenjë të dobishme për mësimnxënësit që të punojnë me të, ashtu siç të bërit e formave domethënëse, gjurmët e putrave të një qeni që ka humbur apo vizatimi i gjurmëve të putrave të ujkut në tabelë.

**Simbolike** – në të cilën mësuesja përdor tekste gjuhësore të artikuluar apo të shkruar duke përdorur kodet formale të sintaksës alfabetike.



# Cilat janë teknikat që mund të përdoren?

Metafora është në mënyrë natyrale e lidhur me dramën duke qenë se të gjitha aktivitetet dramatike janë metaforike në kuptimin që prezantojnë momente karakteristike apo domethënëse të ekzistencës njerëzore. Fija që përshkon një proces drame në edukim mund të jetë që nga mitet e lashta shqiptare apo botërore, tek fija e mëndafshit që dilte nga krimbat e kultivuar dhe që kishte kulmin e tregtisë në shekullin XVII-XVIII, deri tek fijet kablore që përdor teknologjia sot për ta sjelle botën më pranë e për t'i shtuar e shpejtuar dijet njerëzore.

Të gjitha këto fije të përdorura duhet të thurin një pëlhurë të angazhimit emocional dhe mendor të fëmijëve në procesin e të nxënësve që ofron mundësinë që ta arrijë metodologjia e Dramës në Edukim. Mjaft studiues dhe praktikues të dramës si Heathcote(1991), Bolton(1984), e kanë mbështetur mendimin se kontributi i dramës në procesin e të mësuarit është shumë i madh pikërisht nga ndërthurja e angazhimit emocional dhe intelektual që ofrojnë një pasqyrë mjaft të veçantë të çështjeve të trajtuara apo të zgjedhura për t'u eksploruar e që burojnë nga trashëgimia kulturore, nga përvojat njerëzore, të përzgjedhura nga epoka të ndryshme të zhvillimit që nga lashtësia e deri në përvoja aktuale.

Programet duhet të ndërtohen mbi bazën e imagjinatës dhe bërjes së një tregimi bazuar mbi fakte historike, gjuhësore, elementë kulturorë dhe mund të ketë ftesa për heqje paralelesh mes kulturash, në varësi të nevojave të mësimdhënësve. Përzgjedhja e temave që janë problematika në vendin tonë (p.sh. si ajo e pengesave që sjell një komunikim jo i duhur në realizimin e detyrave në vende të ndryshme pune) ndihmojnë në ndryshimin e sjelljes dhe qasjes që nxënësit do të kenë për botën. Mësimdhënësit duhet të përcaktojnë shumë qartë që në fillim strukturën pedagogjike, me objektivat dhe rezultatet e saj. Informacionet duhet të jenë të sakta dhe të respektohet e drejta e autorit për materialet e përdorura. Duhet paramenduar mbi ambientin se ku do

të zhvillohet. Nëse si ambient për zhvillimin e mësimin mes dramës do të përdoret vetëm klasa ku zhvillohet mësimi, atëherë gjithçka ndodh aty dhe duhet menduar si do të vendosen nxënësit, në formën që e mbajnë klasën cdo ditë, apo do ketë rikonceptim të ri. Ndërsa nëse duhen edhe ambiente të tjera, si p.sh. salla e aktiviteteve, apo ndonjë pjesë korridori, atëherë duhet të sigurohet leja nga drejtuesit e shkollës.

Po e marrim konkretisht fushën "Gjuhët dhe komunikimi: nxënësit duhet të aftësohen që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Po e marrim edhe një tregim si model pune, të cilin do ta zhvillojmë më vonë përsëri.



## Tregimi Karriget prej druri

(ky tregim është krijuar si një model bërthamë pune për mësim të integruar nga S.K dhe Sh.B)

'Na jetonte në shekullin e XIX-të një tregtar i pasur, në qytetin e Gjirokastrës, i cili po përgatitej për dasmën e së bijës së vetme. Donte që të flitej kudo për atë dasmë dhe të kishte një të ftuar të rëndësishëm, ndaj kishte nisur të pyeste miqtë e ngushtë për mjeshtrat më të mirë në rajon. Për tavolinat dhe karriget i thanë se mjeshtrit më të mirë të drurit i kishte Dibra, ndaj pasi mori adresën, ai i shkroi mjeshtrit Bajrami për nevojat e tij.'

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit)

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësisht.

Nëse marrim të lexuarit e teksteve të ndryshme, nxënësi do duhet të përdorë strategjitë e të lexuarit për të kuptuar njohuritë në tekste letrare (poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane, drama) apo joletrare (udhëzime të shkurtra, sqarime, fjalime, argumente, artikuj në gazeta dhe revista)

Duke e zhvilluar orën e mësimin thjesht si lexim, nxënësi angazhohet pjesërisht dhe e ka më të vështirë të asimilojë materialin se sa duke e zhvilluar sipas metodologjisë Drama në Edukim, e cila e angazhon plotësisht mes teknikave të saj.

Mësimdhënësit mund të përdorin p.sh. teknikën “Mësuesi në rol” që i jep mundësinë të kontrollojë dramën nga brenda, të zhvillojë narracionin dhe të nxisë të lexuarit duke ngritur pyetje ndaj zgjedhjeve të bëra nga nxënësit, por edhe teknika të tjera si:


### Karrigia e Nxehtë




### Tablotë/Imazhet e Ngrira



### Gjurmimi i Mendimeve



### Sajimi/ Zhvillueshmëria



### Aktiviteti Pantomimë



### Reportazhi



Natyra e procesit do të përcaktohet nga materiali i përzgjedhur dhe objektivat e mësimi. Megjithatë aktiviteti ka në bazë ‘lojën’ duhet shumë kujdes në vërtetësinë e veprimeve, përdorimit të zërit dhe sinqeritetit. Roli nuk ka domethënie e ndonjë figure artistike, por të sjelljes së një karakteri nga një situatë jetësore e cila duhet eksploruar. Mësimdhënësit duhet të vendosin paraprakisht se roli i tyre do të jetë:



#### Si burim ngacmimi të kureshtjes

(p.sh. një Klient që ka nevojë për karrige);



#### Si kontrollues të aktivitetit dhe veprimit

(p.sh. një përgjegjës sektori që zhvillon mbledhje për mbarëvajtjen e punës)



#### Si ftesë për përfshirjen e të gjithëve

(p.sh. një pronar punishteje druri – Shitësi- që thërret punëtorët për të ndërmarrë një realizim të shpejtë e të veçantë karrigesh)



#### Si burim i krijimit të zgjedhjeve dhe dykuptimisë

(p.sh. Cili material do të përdoret për karriget e reja (kostoja, koha e përpunimit, etj.)

Më pas duhet zgjedhur ndonjë objekt (rekuizitë) ose detaj kostumografie që ndihmon në dallimin mes mësuesit të përditshëm dhe mësuesit në rol. Transformimi duhet të jetë sa më i vërtetë që në çastin që merret apo vishet detaji i rolit dhe nga aty duhet krijuar terreni sa më i përshtatshëm për nxënie nga brenda dramës.

Në çdo rast nuk duhet harruar se qëllimi i gjithë aktivitetit është të nxënit dhe teknikat dramatike vetëm sa i krijojnë mundësinë mësimdhënësve të lënë mënjanë figurën e përditshme qëndrimin ulur në karrige pas një tavoline pune përballë tyre dhe për të krijuar një marrëdhënie me një hapësirë tjetër dhe një tjetër status mes tyre dhe nxënësve që do të krijojë një energji më produktive.



# PJESA E DYTË

# SFIDA TË REJA, NJOHURI TË REJA



## Të krijosh mundësi për përdorimin e dramës

Përdorimi i dramës në klasë nuk është i sugjeruar për çdo klasë dhe çdo orë mësimi. Kërkon planifikimin, entuziazmin dhe dëshirën e mësimit dhe parapërgatitje të kujdesshme. Edhe pse e dimë që në fillim duket e vështirë të punuarit me dramën dhe se është më mirë të nisim me hapa të vegjël e pak nga pak, ne mbështesim mendimin se të përdorësh dramën në klasë ia vlen vërtet. Me pjesën më të madhe të mësimit që jemi takuar e kemi parë nxitjen e tyre për ta provuar mësimin me dramë, por na janë përcjellë edhe arsye të ndryshme droje për ta realizuar provën e parë. Disa nga arsyet që kanë krijuar hezitim tek ata dhe që ne i kemi konsideruar të rëndësishme për t'i dhënë përgjigje janë:

| Droja  | Antidroja  |
|--|--|
| Nuk jam i/e mirë në aktrim, ose nuk jam aktor/e. Nuk kam qenë asnjëherë në teatër.                               | Për të përdorur dramën në klasë nuk ka nevojë të jesh aktor/e i.e mirë, majde nuk ka nevojë as ta kesh pasur një "ëndërr në sirtar". Ndërsa elementë të përdorimit të dramës të gjithë ju mund t'i keni përdorur kur u është dashur në klasë të merrni vëmendjen e nxënësve, duke përdorur variacione me zërin, duke krijuar atmosferë në klasë, duke përdorur gjeste dhe qëndrime, etj.   |
| Nuk jam rehat me krijimtarinë, ndjehem me rehat thjesht me zbatimin e mënyrës me të cilën kam operuar deri tani. | Nuk ka nevojë përdorimi i dramës në klasë për krijimtari në kuptimin e artit apo artistikes, aftësitë që duhen në një proces të tillë kanë të bëjnë me të dëgjuarit, me angazhimin për të kuptuar dhe me përqendrimin tek problemet e jo tek dhënia gati e zgjidhjeve  |
| Nuk kemi hapësirën e mjaftueshme në klasë dhe salla e aktiviteteve nuk mjafton.                                  | Pjesa më e madhe e klasave janë të kufizuara në përdorim, por nuk është domosdoshmëri hapësira e madhe për të bërë dramë, por shfrytëzimi i mençur i hapësirës që ke në rrethanat e mësimit. Mund të jepet tjetër formë, mund të shtyhen në cepa dhe të krijohet një hapësirë në mes, mund të ndahen në grupe duke lënë një hapësirë prezantimi, ndërkohë që ata që janë ulur në karrige bëjnë publikun aktiv, etj.<br><br>Sigurisht që ka raste kur duhet hapësirë, por mundet edhe hapësira e klasës të përshtatet me nevojat e dramës dhe mësimit të zgjedhur për t'u mësuar mes saj. Rikujtojmë se drama në klasë nuk e ka objektin prezantimin në publik, përveç se në rastet kur mësimit duan ta prezantojnë një punë që ka shkuar mbarë e mund të merret si model arritjeje apo diskutimi.. |
| Ka kaq shumë presion ngarkesa e kurrikulës dhe kam frikë që koha nuk mjafton.                                    | Megjithëse do të ishte shumë e favorshme që të kishit orë të kushtuara dramës, përsëri nuk është domosdoshmëri që ajo të shtrihet gjatë në kohë. Drama mund të përdoret edhe vetëm 10 minuta brenda një ore mësimore dhe përsëri të jetë efektive. Nuk kemi takuar deri më tani asnjë nxënës apo të rritur që e ka provuar dramën dhe nuk ka dashur ta bëjë përsëri.   |

# Përgatitja e mësimdhënësit

Shumë pak nxënës mund të kenë atë që quhet talent për aktorë dhe sigurisht po aq më pak mësimdhënës mund të kenë talent për regjisorë. Mirëpo për shkak se e kemi provuar ne besojmë të ngacmojmë kurajon tuaj për të eksploruar mundësi për të nxënit përmes dramës në klasë në rrugë të reja argëtuese dhe të dobishme. Përdorimi i dramës në klasë nuk duhet të presupozojë një situatë që mund ta quajmë "ne dhe ata", domethënë një grup 'aktorësh' që luajnë dhe një publik pasiv që vetëm 'bën sehir'. Duhet të përfshihet e gjithë klasa në vendmarrje dhe në proces zbulimi, ndërkohë që eksplorojnë potencialet e domethënies së tekstit/situatës. Teksti mund të merret i gatshëm, kur ka domethënie për objektivat e mësimit, ose mes situatës të krijohet një tekst për nevoja të mësimit. Këtë e vendos dhe zgjedh mësimdhënësi.

Çdo mësimdhënës i mirë dhe me empati duhet të përgatitet kur përballet me një klasë të re apo do të përdorë një metodë a teknikë për të parën herë. Përdorimi i dramës veçse ka nevojë për zgjerim të vetëdijshëm dhe krijimit e përvojës me përdorimin e teknikave.

Gjithçka nis me planifikimin dhe nevojat, a do të jetë përcaktim vjetor, i një periudhe të caktuar, p.sh. Prill-Qershor, apo një ditore. Nëse mësimdhënësi do të ketë planifikuar një ditë mësimit mes dramës. Atëherë kalojmë tek tema dhe objektivat e orës e krijimit të skemës bazë (tregimi bërthamë dhe përcaktimi i mundësive të zhvillimit), e cila do të mbushet gjatë procesit. Nëse vendimi merret për të përdorur një tekst dramatik të gatshëm, duhet pasur parasysh se kjo sidomos në fillime duket sikur të lehtëson punën dhe në fakt ashtu është, por angazhimi i nxënësve do të jetë i kufizuar. Gjithsesi, teksti mund të jetë shkëputur nga ndonjë vepër dramatike, tregim, por mund të jetë edhe ndonjë poezi. Nëse p.sh. në lëndën e gjuhës, do të vendosni të zgjidhni një tekst të gatshëm apo një fragment nga ndonjë dramë e njohur pikat e para që ndihmojnë në vendim-marrje do të jenë këto në të djathtë:



**Mundësitë gjuhësore**



**Relevanca në module (tema, përmbajtja)**



**Niveli i tipareve paragjuhësore/ ekstragjuhësore**



**Interesi i brendshëm**



**Prakticitet në rrethanat e kohës së mësimit, numrit të nxënësve, hapësirë, etj**



**Mundësi zgjerimi (përdorim për më tutje)**

Duhet patur parasysh se është me risk të përzgjedhësh një tekst vetëm sepse të pëlqen, nëse përdorimi i tij nuk i shërben objektivave konkrete të temës mësimore. Pra, përzgjedhja nuk duhet bërë vetëm nga entuziazmi. Mësimdhënësi duhet ta ketë të qartë se çfarë kërkon të arrijë edhe në terma të përgjithshëm, edhe në terma konkretë/të veçantë. Përdorimi i dramës nuk mbaron patjetër me mbarimin e orës mësimore. Mund të zgjerohet puna me vazhdimin e veprimtarisë, duke shkruar, bërë kërkime dhe diskutuar më tej, vazhduar si projekt zhvillues në disa orë të tjera, etj. Nuk është me rëndësi a e prezantojmë diku dramën e zhvilluar, ky është vendim që merret së bashku nëse përbën kënaqësi për të njohur edhe të tjerë me këtë punë. Rëndësia e dramës në klasë është tek nxitja e dëshirës për pjesëmarrje në proces njohjeje. Mësimi bëhet për nevojat e nxënësve dhe të orës së mësimit. Roli i mësimdhënësit është që të sigurojë nxitje, drejtim dhe kontroll.

Për një pikënisje të mirë duhet marrë parasysh se nxënësve u duhet ngacmuar kureshtja, pra duhet zgjedhur një material që përmes tensionit dramatik në nivele të ndryshme mund të intrigojë dhe t'i ftojë të anagazhohen. Për mësimdhënësit që do ta provojnë për herë të parë dramën në klasë si material fillestar, pra nga ku fillon procesi, mund të shërbejë edhe thjesht një fotografi, apo pikturë, apo objekt a pjesë kostumi (të gjitha në relevancë me temën mësimore). Kur mësimdhënësit planifikojnë dhe strukturojnë orët e mësimit mes dramës duhet të kenë parasysh se është me rëndësi jo vetëm gjetja e një ideje të mirë që nxit dhe angazhon, por të zhvilluarit e saj së bashku me nxënësit, të krijuarit e domethënies dhe hulumtimi i rezultateve. Mësimet mes dramës kërkojnë një strukturë dramatike.





# Problemi mësimor

Po si mundemi të mësojmë në mënyrë autentike mes një ngjarjeje që ka sjellë shqetësim në një kohë të caktuar tek disa njerëz apo shoqëria në tërësi - e cila implikon si nxënësit, ashtu edhe mësimdhënësit?

Siç e dimë një metodat e mësimdhënies në klasë kategorizohen nga llojet e të menduarit që përfshijnë nxënësit gjatë orës mësimore. Sipas profesor Bardhyl Musait kemi tri faza që mundësojnë ndërlidhjen:



Në një orë mësimi përmes dramës të tria këto mund të arrihen duke e planifikuar orën me përcjelljen e të tria fazave. Për fillimin e orës ose përgatitjen e nxënësve për të ndeshur një përmbajtje të re, praktikues të ndryshëm sugjerojnë dy mënyra:



Ka praktikues që janë pro lojërave që parapërgatisin nxënësit dhe i çlirojnë ata, dhe ka të tjeër që preferojnë që procesi mund të nisë direkt pa nevojën e lojërave. Pra, në fund mbetet të vendosi çdo mësimdhënësi çfarë mund të përshtatet për klasat e tyre.

Ecuria e strukturës së orës së mësimi ka këto etapa: evokimin apo nxitjen e të menduarit; realizimin e kuptimit dhe reflektimin, të gjitha këto mes veprimit 'duke bërë', pra mes dramës.

Një orë mësimi mes dramës mund të plotësojë kështu këto etapa:



Nëse kemi vendosur që 4-5 minutat e para të zhvillojmë lojëra teatrore me qëllim çlirim dhe ngrohjen, ato shihen të përshtaten me rikujtimin e njohurive. P.sh. Nëse jemi tek lënda e historisë dhe kemi vendosur që ngrohjen ta zhvillojmë me ushtrime ç'tensionimi muskular të trupit dhe aparatit të të folurit, një skemë e nxëmjes (skemat e nxëmjes janë të shumta e të larmishme) mund të jetë:

- > Frymëmarrje-nxjerrje e kombinuar me lëvizjen: marrim frymë, duke shtritur krahët anash e ngritur në majë të gishtave dhe nxjerrim frymë duke mbështjellë rreth trupit si përfaqim; (4-6 herë)
- > Kalojmë nga njëri-tek tjetri tinguj të ndryshëm në fillim me zanore dhe më pas me bashkëtingëllore, duke i shoqëruar me një lëvizje të caktuar apo ritëm. Propozimin e parë e jep mësimdhënësi, më pas sipas radhës secili nxënës propozon tingull dhe lëvizje të re, të cilën e bëjnë të gjithë me radhë.

E njëjta gjë, por me një fjalë-shpejtë: (në këtë rast mund të jetë e krijuar me njohuri përmbledhëse të mësimi paraprak) 'Territoret e Shqipërisë në ejaletin e Rumelisë u copëzuan brutalisht me fermane e dekrete të marrëdhëniesve shoqërore-ekonomike që ia vështirësonin jetët njerëzisë.' (thuhet herën e parë një frymënxjerrje, pastaj 2 herë me një frymë-nxjerrje dhe mund të arrijmë deri në tre herë me një frymënxjerrje)



Kjo është etapa më e gjatë e orës së mësimi dhe zhvillohet e tëra mes dramës. Duke krijuar dhe vepruar ngjarjet, marrë vendime, zgjidhur probleme, marrë përgjegjësitë e vendimeve, punuar në grupe dhe prezantuar, ata njëkohësisht kuptojnë njohuritë e reja që ka pas në program plani mësimor.



Kjo është faza finale dhe mund të zhvillohet në 5-10 minuta, sipas vendimit të mësimdhënësit duke reflektuar mbi çfarë u mësua dhe si mund të vazhdohet më tej të ndërtohet diçka e re mbi ato dije. (p.sh. vazhdimi i tregimit apo i një teksti të ri, një material i shkruar pune, një objekt a një kostum, etj,etj.)

Sugjerimet që vijojnë janë menduar të ofrohen si modele për praktikën e mundshme në klasë me të mësuarit mes dramës. Është e mbështetur qëllimisht dhe me kujdes në mundësitë që ofron një tregim krijues bërthamë, i cili nuk ka të prezantuar fundin, por vetëm fillimin. Kjo u mundëson mësimdhënësit që të zhvillojnë arrijtet e klasës në një eksplorim mjaft intensiv dhe ngacmues.

## Cilat janë përgjegjësitë e mësimitdhënësit?



Për mësimitdhënësit që kanë vendosur të provojnë punën mes dramës përveç se ngacmimit dhe një lloj ngazëllimi të bukur që shkakton kjo punë, është me rëndësi të kenë parasysh edhe disa udhëzime që lehtëjnë mbajtjen në kontroll të objektivave mësimore. Mbani mend se teknikat e dramës mund të përdoren veç e veç, por edhe të kombinuara me njëra-tjetrën.

Në fazën e parapërgatitjes, duhet të jetë përcaktuar koha që do t'i kushtohet mësimit mes dramës apo temës mësimore të përzgjedhur. Më pas të vendoset në se është më mirë puna e ndarë në grupe apo të gjithë së bashku.

Me Dramën në Klasë mund të punohet me të tërë klasën, por dhe me grupe të ndara, dy ose katër, në raport me numrin e nxënësve që kanë klasat në shkollat tuaja. Ndarja në grupe është mjaft efikase, por duhet kujdes në përcaktimin e nxënësve në secilin grup që të ketë një lloj ekuilibri zhvillues dhe nxitës brenda grupeve edhe për ata nxënës që nuk janë shumë aktivë gjatë orëve të mësimit, pra duke mos i vendosur nxënësit më të shkathët të gjithë brenda një grupi, apo nxënësit me më pak interes të gjithë brenda një grupi tjetër. Nëse vendosni të ndani klasën në dy grupe të mëdha (26-30 nxënës), atëherë mund t'i jepni secilit nxënës një gërmë (A;B) dhe në fund gjithë A-të bëjnë grupin 1 dhe gjithë B-të grupin 2. Nëse do të vendosni t'i ndani në katër grupe, atëherë mund t'i jepni nxënësve (nëse jeni në klasë të madhe është më mirë të mos qendrojnë në banka, por t'i vendosni në një rreth) një numër (1,2,3,4) dhe në fund të mblidhen në grupin 1 të gjithë 1, e kështu me radhë.

Duhet të jetë e paramenduar sa kohë do t'i lihet secilit grup për të realizuar detyrën e dhënë (nëse koha nuk përcaktohet, atëherë ka mundësi për humbje kohe dhe paqartësi. Për pjesën më të madhe të detyrave brenda një ore mësimore koha për punën në grupe mund të variojë nga 3-10 minuta, por ka raste që mund të jepen detyra të shpejta dhe të lihet vetëm një minut kohë) dhe të përcaktohet qartë Kush? Ku? Çfarë? Si? Pse?

Çfarë ka ndodhur?

Ku dhe kur po ndodh ngjarja?

Si duhet vepruar?

Kush është i përfshirë në situatën e dhënë?

Çfarë duhet bërë për zgjidhjen e problemit?

Pse duhet vepruar kështu?

Detyrat që u jepen grupeve për të realizuar (të ndryshme për secilin grup, por mundet edhe e njëjta për detyra të ndryshme) mund të jenë këto:

| Improvizimi  | Tabloja/Imazhi   | Punë me shkrim   | Kërkim  |
|--|--|--|---|
| Për shembull, atyre u jepet një pikë që ka nevojë për zgjidhje në tregim dhe u kërkohet të zhvillojnë një skenë të shkurtër të ndarë në role | Grupit mund t'i jepet detyrë të krijojë një tablo/imazh apo një skulpturë të një momenti të rëndësishëm të tregimit, prej të cilit do të lidhet zhvillimi i ngjarjes | Njërit prej grupeve mund t'i caktohet përmes roleve shkrimi i një letre, apo një udhëzimi, apo gjithçkaje me shkrim që ka nevojë ngjarja | Nëse ka nevojë për informacione që nuk i dimë plotësisht në ngjarje, atëherë grupit i caktohet detyra të kërkojë në libër mësimit apo tekst burimor dhe të rendisin të dhënat që do t'i ndihmojnë ngjarjes. |

Detyrat që u jepen grupeve për të realizuar (të ndryshme për secilin grup, por mundet edhe e njëjta për detyra të ndryshme) mund të jenë këto:



**Organizimi:** brenda grupeve ka nevojë për një organizim të kujdesshëm që puna të mos ngajë thjesht me një lojë argëtuese. Ka raste kur ndoshta është e udhës të ketë drejtues grupi, ose vetë mësimdhënësit të kontrollojnë grupin duke hyrë në rol në raste të caktuara.

**Niveli:** Shtë e vështirë të punohet për zhvillim dhe përparim në detyrat në një nivel të përshtatshëm për secilin grup.

**Kontrolli:** për mësuesin mund të bëhet i vështirë kontrolli nëse detyrat e dhëna grupeve janë shumë të ndryshme nga njëra tjetra, nëse grupet nuk i marrin seriozisht detyrat e dhëna, nëse nuk e konsiderojnë detyrën si imperativ, pra që duhet bërë tani dhe sa më shpejt sepse dikush ka nevojë. Mësuesi mund të përdorë lojën 'Ngrij' në momente të caktuara të punëve në grupe dhe duke i shkruar pranë secilit pjesëtar të grupit dhe prekur lehtë në sup me qëllim që ai/ajo të thonë se çfarë po bëjnë në atë pikë të punës.

**Koha:** Një nga vështirësitë që haset është koha e reflektimit të punës në grupe, shpesh ajo duhet të jetë e kufizuar dhe e përmbledhur shkurt dhe qartë.

**Konkurrenca:** duhet bërë e qartë nxënësve se puna në grupe nuk e ka si qëllim të përcaktojë se cili grup është më i mirë, por ka si objektivi zhvillimin e ngjarjeve dhe zgjidhjen e problemeve.

Gjithashtu, se në prezatimin e punës në grupe duhet të përfshihen të gjithë, jo vetëm ata që janë më të shkathët në komunikim.





# PËRMBYLLJE

Do të dëshironim ta përfundonim këtë udhëhapës duke përmbledhur disa gjëra që ne që i shohim veçanërisht të rëndësishme në përdorimin e dramës në klasa. Drama në Klasë nuk është pjesë e kornizës kurrikulare të arsimit profesional, por mund të jetë në përdorim në të ardhmen kur të jenë përgatitur arsimtarët e duhur. Për momentin në të cilin është hartuar ky udhëhapës po provohet të realizohet si metodë për mësimin e disa subjekteve lëndore, duke trajnuar teorikisht dhe praktikisht mësimdhënësit të shkollave profesionale në një program pilot, për Seiss Foundation for Technical Cooperation e programin 'Rrugë të reja për Arsim Gjithëpërfshirës'.

Çdo provë e re dhe kërkim i ri duhet t'i shërbejë humanizmit, kështu gjatë këtij udhëhapësi kemi mbajtur parasysh se edhe rrënjët e praktikave të ndryshme të kulturës mësimore janë pikërisht aty. Drama i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe jetën që vjen pasi përfundohen vitet e shkollës, i ndihmon pikërisht të kuptuarit se si mund dhe duhet vepruar në rrethana të ndryshme profesionale, por edhe personale. Ndërsa mësimdhënësit i ndihmon për orë mësimi mjaft të gjalla dhe të dashura, edhe pse sigurisht që kërkojnë parapërgatitje. Ndryshimet dhe sugjerimet e teknikave këto vite në Shqipëri kanë qenë të shumta dhe jo pak herë edhe kanë krijuar paqartësi, ndaj ne kemi menduar se e gjithë kjo punë pa prezantimin praktik do të ishte përgjysmë. Jemi të lumtur që kemi nisur një kontribut që do të vijojë sepse në këtë lëmi mundojnë burimet ndihmuese në përdorim. Dëshira jonë do të ishte që aplikimi i dramës të zgjerohet dhe të konsiderohet jo thjesht si një mësim mes lojës, por një qasje në edukim sa shkencore, po aq edhe organike. E theksojmë jo më kot këtë, pasi jemi ndeshur jo pak herë me keqpërdorim të teknikave apo përdorim të pjesëshëm duke iu larguar objektivit kryesor, rezultateve të të nxënësve që përmban plani

mësimor. Përvoja njerëzore e ka provuar se teatri është joshës dhe se ka mundësi edhe të nxisë efekte të jashtme dhe plot ngjyra e forma dhe të rrisë dëshirën për dukje e në vend që të çlirojnë mundet që të dëmtojnë. Por Drama në klasë e ka dëshmuar që mundet të jetë një metodë shumë e fuqishme mes së cilës mësimdhënësi mund të arrijë të shkundë rezistencën e nxënësve ndaj të mësuarit dhe të krijojë ambient të dashur në të cilin mund të eksplorohej tema të ndryshme mes të cilave krijohet domethënie dhe nxitet empati. Duke hapur udhë për imagjinatën dhe nxitur pjesëmarrje, përmes metaforave dhe kërkimit të përgjigjive nxënësit dhe mësimdhënësit mund të rigjallërojnë mënyrën e të mësuarit dhe marrëdhëniet në klasë. Besojmë se për të gjithë arsimtarët që e synojnë përdorimin e dramës në klasë duhen thelluar trajnimet duke i pajisur me njohuritë e duhura dhe aftësitë e duhura për përdorim profesional. Kjo do të ulë drojën dhe rrisë vetëbesimin dhe dëshirën për të krijuar e realizuar më gjerë. Urojmë njëkohësisht që të rinjtë që diplomohen në fakultetet e edukimit dhe të arteve të pajisen me këto njohuri që gjatë viteve të arsimit universitar e të zhvillojnë praktika të reja të dramës dhe teatrit aplikativ.

Sipas studiuesve të dramës në edukim dhe teatrit pedagogjik janë katër paradigma të dramës në edukim mes të cilave trajtohen dijet:

- njohëse / procedurale (fitimi i njohurive dhe aftësive në dramë)
- ekspresive / zhvillimore (rritja përmes dramës)
- sociale / pedagogjike (të mësuarit përmes dramës)
- funksionale (atë që njerëzit bëjnë në dramë)

Ajo me të cilën ne kemi hartuar këtë udhëhapës është paradigma sociale/ pedagogjike, e cila është një praktikë bashkëkohore që mbështetet në teoritë social-konstruktiviste të Jerome Bruner dhe Lev Vygotsky, që lidhin të menduarit me gjuhën dhe të mësuarit. Mësimdhënësit si drejtues të orëve mësimore përmes dramës, njohuritë e krijuara tek nxënësit përmes përvojave të tyre, i strukturojnë dhe u japin kuptim duke i lidhur me programin mësimor, pra duke i bërë, duke i aktivizuar nxënësit mendërisht, fizikisht dhe emocionalisht.

Do të kishim dashur ky udhëhapës të ishte edhe më i plotë me ilustrime të realizuara në klasa, por turbullimi shoqëror që shkaktoi gjendja e pazakontë i ndërpreu disa aktivitete të gjalla duke i zëvendësuar përkohësisht me mësimin në distancë. Besojmë të kemi hapur një rrugë të re mendimesh dhe ndjenjash, për t'ia lënë vendin bashkëpunimit në klasa duke qenë prezentë në vitin e ri shkollor që kemi përpara.

# BIBLIOGRAFIA

- > Barba Eugenio, "Kanoa prej letre", përkthyer nga Romeo Kodra, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015;
- > Bardhyl Musai, "Mësimdhënia dhe të nxënëti ndërvprues", Tiranë, 2005;
- > Egan Kieran, "The educated mind", Chicago, 1997;
- > Egan Kieran, "An Imaginative Approach to Teaching", San Francisco, 2005;
- > Freire Paulo, "The politics of education, Culture, Power and Liberation", New York, 1985;
- > Freire Paulo, "Pedagogy of the Oppressed", New York, 1970;
- > Fromm Erich, "Njeriu për vete", Phoenix, 2003;
- > Johan Georg von Hahn, 'Studime Shqiptare', IDK, 2007;
- > Jerom Bruner, "The process of Education", Harvard University Press, 1977;
- > Malinowski Bronislaw, "Antropologjia Social-Kulturore", Ideart, 2007;
- > Monaghan John dhe Just Piter, "Antropologjia Social-Kulturore", përkthim Bashkim Shehu, IDEART, Tiranë, 2000;
- > López Jiménez Pérez, Cuenca, & Listán Ferreras, "Heritage education: Exploring the conceptions of teachers and administrators from the perspective of experimental and social science teaching", 2010;
- > Kapidani Sonila, "Metodika për estetikën e komunikimit", Westprint, Tiranë, 2011;
- > Varenne Herve & Koyama Jull, "Educational Antropology", 2006;
- > Vigotsky Lev, "The problem of the cultural development of the child, The journal of Genetic Psychology", 1929;
- > Wooster Roger, "Theatre in Education in Britain: Origins, Development and Influence", Bloomsbury, 2016.

## Revista

- > "The fight for drama the fight for education" – NATD, from the conference 1989;
- > "The journal for Drama in Education", NATD, volume 17, Issue 1, 2000, Volume 18, Issue 2, 2001;
- > SCYPT Journal, Issue 28, August 1994, "A Perspective", Ian Yeoman.

## Faqe interneti

- > <http://theses.gla.ac.uk/2535/1/1979redingtonphd.pdf>
- > Egan Kieran, <http://www.rosejournal.com/index.php/rose/article/view/71/99>
- > Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, MAS, 2014, fq.54
- > IZHA, 2012
- > Korniza e Kurrikulës, 2011 fq.1, [http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Korniza\\_e\\_kurrikules11.pdf](http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Korniza_e_kurrikules11.pdf)
- > [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/PROGRAMI\\_GJUHE\\_SHQIPE,\\_SHKALLA\\_1.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/PROGRAMI_GJUHE_SHQIPE,_SHKALLA_1.pdf), fq.8
- > [www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/335116/Master\\_final\\_national\\_curriculum\\_220714.pdf](http://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/335116/Master_final_national_curriculum_220714.pdf), fq.5
- > Abot Luke, "Dramatic Exercises for teacher", <http://www.mantleoftheexpert.com/studying/articles/LA%20-%20Dramatic%20exercises%20for%20teachers.pdf>
- > [https://www.academia.edu/31753319/TRASH%C3%8BGIMIA\\_KULTURORE\\_N%C3%8B\\_ARSIMIN\\_FILLOR\\_MES\\_METODOLOGJIVE\\_DRAMA\\_DHE\\_TEATRI\\_N%C3%8B\\_EDUKIM\\_SONILA\\_KAPIDANI](https://www.academia.edu/31753319/TRASH%C3%8BGIMIA_KULTURORE_N%C3%8B_ARSIMIN_FILLOR_MES_METODOLOGJIVE_DRAMA_DHE_TEATRI_N%C3%8B_EDUKIM_SONILA_KAPIDANI)
- > <https://ascap.edu.al/Biblioteka/3Programe%20Lendore/4Programet%20e%20Arsimit%20te%20Mesem%20Kurrikula%20e%20re/Programet%20e%20klases%20se%2010/Programet%20e%20Klas%c3%ab%20s%c3%ab%20X,%20Kurrikula%20me%20Zgjedhje/Teater.pdf>



# SHTOJCË 1. TEKNIKAT E DRAMËS NË EDUKIM

## Mësuesi në rol

### Përse mund të përdoret?

Kjo teknikë inkurajon nxënësit të hyjnë dhe të përfshihen me trillimet e dramës. Nëse mësuesi është i angazhuar në mënyrë aktive me rolin e tij / saj, ua lehtëson nxënësve hyrjen dhe përfshirjen e roleve të tyre.

Mos harroni se mësuesi ka ende si qëllim mësimin, por mësimi është negociuar në rol, duke lejuar mësuesit dhe nxënësit të lënë mënjane rolet e tyre të përditshme dhe të krijojnë marrëdhënie të cilat kanë një larmi të statusit dhe fuqi të ndryshme.

Mësuesi në rol mund të kontrollojë dramën nga brenda, të zhvillojë trillimin e narracionit dhe të vërë në dyshim zgjedhjet e bëra nga nxënësit.

Mësuesi në rol gjithashtu mund t'i japë një besueshmëri të madhe dramës dhe i nxit njerëzit të përfshihen në krijim.

### Si bëhet?

Shpjegojini grupit se do të luani një personazh të veçantë në dramën që po eksploroni si klasë. Natyra e rolit që ju merrni do të varet nga ajo që dëshironi të arrini.

### Shembuj:

- > Për të nxitur interesin (p.sh. një Klient që ka nevojë për karrige)
- > Për të kontrolluar veprimin (p.sh. një përgjegjës sektori që zhvillon mbledhje për mbarëvajtjen e punës)
- > Për të arritur përfshirje (p.sh. një pronar punishteje druri që thërret punëtorët për të ndërmarrë një realizim të shpejtë e të veçantë karrigesh)
- > Për të krijuar zgjedhje dhe paqartësi (p.sh. Cili material do të përdoret për karriget e reja (kostoja, koha e përpunimit, etj.)

Zgjidh një detaj kostumi ose një rekuizitë që do të tregojë se kur je në rol. (përparëse pune, metër, mjet punet, etj)

Sapo do të vishni kostumin apo detajin e kostumit apo do të merrni rekuizitën në dorë, menjëherë do të bëheni karakteri që keni zgjedhur dhe prej aty do të mund të menaxhoni mundësitë e të mësuarit përmes dramës. Aftësia që duhet është vërtetësia dhe vëmendja mbi qëllimet e të mësuarit prej nga roli.

## Karrigia e nxehtë

### Përse mund të përdoret?

Karrigia e nxehtë lejon klasën (duke punuar si vetja e tyre) të pyesë ose intervistojë njerëzit në rol. Kjo mund ta ndihmojë grupin të mësojë më shumë rreth këndvështrimit të një personazhi. Nxënësi që do të ulet në karrige përballë klasës, në tregimin tonë do të quhet "Klienti".

### Si duhet bërë?

"Klienti" ulet në karrige përballë klasës.

Klasa mund t'i bëjë pyetje personazhit në karrigen e nxehtë. Këto ndoshta do të jenë pyetje për të nxitur njohuritë e grupit mbi atë karakter. Është e rëndësishme që personi që është ulur në karrigen e nxehtë të jetë në rol për gjithë kohëzgjatjen e seancës.

Personi që merret në pyetje duhet të përgjigjet në përputhje me atë që ai tashmë di për karakterin, por nëse një pyetës kërkon më shumë informacion, personi thjesht mund të përdorë imagjinatën e tij / saj për të thëlluar karakterin.

### Pyetje të mundshme:

- > Sa karrige dhe sa tavolina duhen gjithsej?
- > Deri kur është afati i dorëzimit?
- > Deri në sa para ke ndër mend të shpenzosh për karriget e çiftit?
- > Modelin e do me elementë nga tradita shqiptare apo e huaj, apo kombinim?

(shembull 2) - Ulet në karrigen e nxehtë **Shitësi** (mjeshtri i karrigeve).

- > Çfarë druri do të përdorësh për porosinë?
- > A ka interes porosia që sapo të ka ardhur?
- > A ke besim se do t'ia dalësh mbanë në kohën e duhur?
- > A të duhen punëtorë shtesë





## Tabloja/imazhi

### Përse mund të përdoret?

Kjo është një teknikë që përdoret më shpesh.

Kjo është mënyra më e mirë për të filluar punën me dramën, sepse është një ushtrim i thjeshtë dhe nuk të vë në siklet për grupe me pak ose aspak përvojë me dramën. Tabloja/ Imazhi ndihmon për të zhvilluar aftësitë e të punuarit në grup. Është një formë shumë e kontrolluar e të shprehurit që krijon fotografi që mund të interpretohen nga klasa – një imazh vlen më shumë se një mijë fjalë!

Është gjithashtu një rrugë shumë e mirë për të prezantuar e diskutuar mbi koncepte të vështira, si grindjet/sherret dhe ide abstrakte si liria, apo trishtimi, etj.

### Si duhet bërë?

Ndajeni klasën në grupe prej 4 apo 5 vetësh.

Shpjegoni se do të krijoni një imazh, i cili është sikur dikush ka shtypur pauzë në një DVD. Imazhi nuk do të ketë tinguj apo lëvizje. Është shkrepje e rrufeshme. Kërkojini njërit grup që të prezantojë një shembull për klasën. Jepini grupit një temë për imazhin e tyre, p.sh. një fotografi familjare apo një çast pauzë nga puna e një grupi punëtorësh. Nxiteni grupin që të mendojë se çfarë e bën më interesant imazhin në nivele të ndryshme – pozicionin, shprehitë e fytyrës, veprimin, etj.

Kur secili grup ka punuar me tablonë e vet, atëherë do ta prezantojnë para klasës dhe do të diskutohet mbi atë se çfarë mendojnë se është apo prezanton. “Cila është marrëdhënia mes personazheve që shohim në këtë tablo?”; “Si mund të kuptojmë se çfarë është duke ndodhur?”

Është e dobishme që të vihet re ndryshimi i opinionëve dhe se si njerëz të ndryshëm kanë mënyra të ndryshme për ta parë ngjarjen.



## Gjurmimi i mendimeve

### Përse mund të përdoret?

Gjurmimi i mendimeve lejon audiencën që të njohë mendimet e brendshme të një personazhi. Kjo mund të përdoret me një skenë që është e ngrirë për një çast ose për të ditur mendimet e një personazhi brenda tablosë.

Gjurmimi i mendimit i nxit nxënësit të reflektojnë mbi veprimin e dramës dhe të marrin në konsideratë këndvështrimin e personazhit që luajnë. Duke lejuar grupin të dëgjojë mendimet e të gjithë personazheve në skenë / imazh, ndjekja e mendimit inkurajon një vetëdije për pikëpamjet e të tjerëve dhe pasojat e mundshme të ngjarjeve / veprimeve.

### Si bëhet?

Një grup duhet të ngrijë në mes të një skene (preferohet një çast shumë i rëndësishëm i ngjares) apo të një tabloje. Shpjegojini që ju do të hyni në tablo dhe do të prekni në sup pjesëtarë të grupit. Qartësojini që kur do ta bëni këtë, kjo do të thotë që personi duhet të flasë me zë mendimet e personazhit të tij në atë çast.

Theksoni që dëshironi që ata të flasin mendimet si karakter, p.sh. “Nuk besoj se do arrijmë t’i përfundojmë në kohë”.

Kur të gjithë personazhet janë duke “ndjekur mendimet”, skena mund të vazhdojë, ose mund të eksplorohet edhe ndonjë tjetër imazh njëkohësisht, pra dy grupe paralele.

## Sajimi

### Përse mund të përdoret?

Sajim është një term i thjeshtë për të krijuar dramë origjinale – me fjalë të tjera, të krijosh vetë skenat e tua! Në këtë teknikë punohet më mirë me grupe prej 4-5 vetësh me qëllim krijimin e skenave interesante dhe nuk e bën të vështirë punën në grup.

### Si bëhet?

Ndani klasën në grupe prej katër ose pesë. Jepni udhëzime të qarta në lidhje me temën e dramës - shpesh është e dobishme t’u jepni grupeve udhëzime me shkrim ose një lloj ndihme vizuale për të vepruar si një stimul për krijimtarinë.

Jepini një kohë grupit për përgatitjen deri në çastin që do ta ndajnë me të tjerët.

Inkurajoni grupet që të veprojnë sa më shpejt idetë e tyre. Shpesh është shumë joshëse që grupet të ulen dhe të flasin për ide për një kohë të gjatë. Sajimi bëhet më i lehtë nëse provoni ide, zakonisht më shumë do të vijnë përmes veprimit fizik. Inkurajoni nxënësit të zgjedhin emra të tjerë për personazhet e tyre, sesa emrat e tyre të vërtetë,

p/sh. Klienti – Z. Babameto; Mjeshtri - Z. Bajrami.

Kjo ndihmon në përcaktimin e qartë midis dramës dhe realitetit. Jepini hapësirë grupeve për të krijuar dhe për të eksperimentuar me idetë e tyre.

## Pantomima

### Përse mund të përdoret?

Pantomima është një lëvizje fizike dhe vepruese në të cilën mund të futësh edhe tinguj për të krijuar atmosferë më të plotë.

Pantomima është teknikë e mirë për t'u përdorur me të rinj që ndoshta janë të rinj në përdorimin e dramës dhe rezultatet mund të arrihen pa presionin e të folurit. Pantomima mund ta prezantojë grupin me një performancë më të stilizuar, abstrakte, e cila, kur shoqërohet me muzikë, është një formë e mirë e vallëzimit.

Dhe kur interpretohet me lëvizje të ngadaltë, pantomime është po ashtu efikase për ngjarje të vështira, si: grindjet, ndjeshjet e futbollit, dhënia e udhëzimeve, etj.

### Si duhet bërë?

Sigurohuni që grupi ta dijë se çfarë do të thotë "pantomimë" - jepni një shembull duke përdorur një pjesëmarrës vullnetar! Një mënyrë e mirë për të angazhuar butë në pantomimë është të luani një lojë e cila prezanton disiplinën e kërkuar për të krijuar efektivisht imitim për një audiencë. Mund të jetë mirë t'i kërkohe grupit të imitojë individualisht në fazat e para, mbase duke imituar diçka me të cilën ata janë shumë të njohur, p.sh. Të ngulin një gozhdë, të lajnë duart, etj. Inkurajoni grupin të bëjë lëvizjet e tyre sa më të qarta. Lëvizjet e mëdha janë të mira! Kërkojuni atyre të mendojnë për shprehjen e fytyrës po aq sa zonat e tjera të trupit - si ndihet ky personazh për atë që po bëjnë?

## Reportazhi

### Përse mund të përdoret?

Reportazhi është një teknikë drame që paraqet ngjarjet përmes mediumit të raportimit të lajmeve, dokumentare ose TV. Prandaj është një formë dramë shumë e pëlqyeshme dhe e njohur për të rinjtë.

Reportazhi i mundëson grupit të eksplorojë të dy palët e një çështjeje dhe të përqëndrohet në pikëpamjet e ndryshme të përfshira në çdo ngjarje.

Kjo teknikë gjithashtu mund të përdoret për të eksploruar sesi ngjarjet mund të shtrembërohen/tjetërsohen nga shtypi.

### Si duhet bërë?

Kjo teknikë është në thelb një ushtrim sajimi.

Pra, ndajeni klasën në grupe, duke siguruar që ka mjaft anëtarë të grupit për të mbuluar karakteret e nevojshme.

Jepini secilit grup një histori të përgatitur lajmesh që duhet të mbulojë, me aq detaje sa i konsideroni të nevojshme, p.sh. lajmin për dasmën e z.Babameto dhe modelin e veçantë të karrigeve.

Kërkojuni secilit grup të vendosë se cilat personazhe duhet të përfshihen në raportin e lajmeve.

Inkurajoni ata të marrin parasysh se kush paraqet lajmin, kush i zhvillon intervistat, kush intervistohet, a ka ndonjë filmim? Sigurohuni që grupet të kenë një argument të ekuilibruar brenda raportit, ose të paktën të japin një arsyetim nëse raportimi është i pabalancuar/subjektiv!

## SHËTOJCË 2. PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSIT: SHEMBULL PLANIFIKIM PERIODIK

| Periodha: p.sh. Shtator – Tetor   |   |  |  |   |
|---|---|--|--|---|
| Tematika-Kapitulli  | Temat mësimore  | Situata e parashikuar e të nxënësve  | Vlerësimi  | Burimet   |
| Të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve për qëllime personale dhe funksionale | Komunikimi dhe llojet e tij                             | Hartimi i një letër porosie dhe i një letër përgjigjeje. Komunikimi Klient- Shitës. Teknika 'Tabloja'  | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësimi i aktivitetit gjatë debeteve në klasë; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim; | Tregimi "Karriget prej Druri"<br>Gjuha shqipe 10                                    |
| Të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme                           | Strategjitë e të folurit dhe strategjitë e të dëgjuarit | Prezantimi i letrave të hartuara për klasën. Secili grup një herë si prezantues – ligjërues, një herë si publik-dëgjues. Teknika e 'Tablosë' | Vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësimi i aktivitetit gjatë debeteve në klasë; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim; | Tregimi "Karriget prej Druri";<br>Materialet e krijuara në klasë; Gjuha shqipe 10   |
| Të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve për qëllime personale dhe funksionale | Strategjitë e të shkruarit. Si korrigohe një tekst      | Situata komunikimi dhe përmirësimi. Teknika e Sajimit  | Vlerësimi i punës në grup; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim  |   |
| Teksti përshkruar   | Teksti përshkruar                                       | Për të krijuar një tablo të re, më se pari përshkruhet puna e deri më tanishme me tregimin   | Vlerësimi motivues e me gojë, vetëvlerësim; Vlerësimi i vazhduar me notë   | Tregimi "Karriget prej Druri";<br>Materialet e reja të krijuara;<br>Gjuha shqipe 10 |

Teknikat: Sajimi, Tabloja


Metodologjia: Drama në Edukim

Lënda: Gjuhë

Ky është një shembull bërthamë, ndërsa tregimi mund të jetë çfarë do që mësimitdhënësi e shih si të përshtatshëm për realizimin e temave mësimore. Tregimi i përzgjedhur duhet të jetë mbi njohuritë e reja dhe zhvillimin njerëzor. Diçka që merret nga e kaluara duhet konsideruar në shërbim të asaj që do të mund të vijë në të ardhmen.

# SHTOJCË 3. TRE SHEMBUJ TË DETAJUAR LËNDOR ME MATERIAL TË PASUR DHE AKTIVITETE

Tre shembujt që do të prezantohen dhe që kanë material mjaft të pasur për orë mësimi të veçanta dhe shumë aktive do të jenë nga lëndët: gjuhë, histori dhe një propozim ndërëndor.



## Drama dhe gjuhë

Modeli është hartuar që të përmbushë këto detyra: zhvillimin e disa aftësive të veçanta të komunikimit përfshi:

- > Dhënien dhe marrjen e informacioneve;
- > Parashikimin dhe planifikimin;
- > Rrëfimin/tregimin
- > Raportimin
- > Arritjen/përcaktimin e konkluzioneve;
- > Nxitjen e sjelljes pozitive ndaj njëri-tjetrit;
- > Respektimin e këndvshërimeve të të tjerëve, vlerave dhe karakteristikave;
- > Të menduarit individual dhe shprehjen e opinioneve;
- > Të punuarit në grup, zhvillimin e aftësive të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve duke mësuar të negociohet dhe ndërmjetësohet brenda grupeve;
- > Eksplorimin e situatave shoqërore dhe dilemave morale;
- > Përmirësimin e vetë-besimit dhe disiplinës.

Po i kthehemi përsëri tregimit bërthamë 'Karriget prej druri' dhe lëndës së gjuhës, kompetencat e së cilës sugjeruar në kurrikul janë (në të djathtë):

| Kompetencat kyçe:                               | Kompetencat e gjuhës:  |
|---|--|
| Komunikimi dhe të shprehurit                    | Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar                           |
| Kompetenca e të menduarit                       | Të lexuarit e teksteve të ndryshme                                       |
| Kompetenca e të mësuarit për të nxënë           | Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme                                      |
| Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin | Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale                       |
| Kompetenca qytetare                             | Përvetësimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore dhe të pikësimit |
| Kompetenca personale                            |  |
| Kompetenca digjitale                            |  |

**Kujtojmë:** Kompetenca është ndërthurja e dijeve, e aftësive, e qëndrimeve, e vlerave që u nevojiten nxënësve për zhvillimin vetjak, qytetarinë aktive, përfshirjen shoqërore dhe punësimin në të ardhmen.

> (<https://ascap.edu.al/2019>)



## Tregimi

# Karriget prej druri

'Na jetonte në shekullin e XIX-të një tregtar i pasur, në qytetin e Gjirokastrës, i cili po përgatitej për dasmën e së bijës së vetme. Donte që të flitej kudo për atë dasmë dhe të kishte një të ftuar të rëndësishëm, ndaj kishte nisur të pyeste miqtë e ngushtë për mjeshtrat më të mirë në rajon. Për tavolinat dhe karriget i thanë se mjeshtrit më të mirë të drurit i kishte Dibra, ndaj pasi mori adresën, ai i shkroi mjeshtrit Bajrami për nevojat e tij.'

Nevoja e parë e tregtarit nga Gjirokastra është të komunikojë nevojën për të realizuar karriget e veçanta tek mjeshtri dibran. Dhe pyetja e parë që do t'i angazhojë nxënësit është 'Si?'. Pasunarin nga Gjirokastra këtej e tutje do ta përcaktojmë si Klienti, ndërsa mjeshtrin dibran si Shitësi.

- > Si do të komunikojë Klienti për porosinë e karrigeve? (Jemi në shek. XIX dhe mënyra e komunikimit që mund të zgjidhet është letër porosia)
- > Si do të arrijë tregtari që ta ketë Ali Pashën të ftuar nderi në dasmën e së bijës?
- > Si do të përgjigjet mjeshtri dibran për porosinë?
- > Si do të vendosë çfarë materialesh i duhen?

Që në çastin që do të nxiten nxënësit që t'i përgjigjen pyetjes 'Si?', ata veçse ia kanë nisur të përqendrohen tek ngjarjet, të krijojnë tregimin e tyre dhe të angazhohen në proces. Është e dukshme që tregimi nuk është plotësisht i dhënë, por vetëm një bërthamë nga ku do të nisë një eksplorim i thellë bashkëprues, sepse vetë nxënësit do të marrin vendime për mënyrën se si do të vazhdojë dhe më pas do të analizojnë pasojat e tyre. Fakti që fundi i tregimit nuk dihet që në fillim është shumë i dobishëm sepse mban tensionin dramatik duke shqyrtuar dhe përcaktuar 'Si?'- të dhe 'Pse?'-të e ngjarjeve të gjithë së bashku.



### Tema:

Teksti paraqitës, porosites, etj. Llojet e teksteve

### Kompetencat:

Komunikimi dhe të shprehurit; Kompetenca e të menduarit; Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale;

### Teknika e dramës:

Tabloja/Imazhi

Nxënësit angazhohen të gjithë duke u ndarë në katër grupe dhe duke punuar që të krijojnë nga dy tablo për grup: dy nga Gjirokastra dhe dy nga Dibra – një tablo do të jetë nga Tregtari - Klienti, ndërsa tjetra nga Mjeshtri i drurit-Shitësi.

Tregimi mund të kapet në çastin që përbën më shumë interes për veprim, p/sh. Tregtari po e marton vajzën me nxitim, pa miratimin e saj, sepse njeriu i rëndësishëm që ka ftuar në dasëm është Ali Pashë Tepelena, i cili në atë periudhë kishte nisur një fushatë internimi të pasunarëve gjirokastritë me qëllim që t'i shpëtojë internimit. Dhe çasti i fotos së grupit të parë është nga një zënkë mes prindërve dhe vajzës, ndërsa e grupit të dytë është përgjigjia e ftesës së dasmës, në të cilën njoftohet se Ali Pasha do të vijë.

Ndërsa tabloja nga Dibra, grupi i parë në një çast kur Mjeshtri po debaton me furnizuesin e lëndës së parë sepse ia ka sjellë porosinë vonë/ose gabim dhe grupi i dytë në përfundimin e llogarive që bëjnë të mundur kthimin e përgjigjes Klientit.

Pasi i kemi bërë tablotë mund ta vazhdojmë tregimin duke formuluar letrën e porosisë që dërgon tregtari nga Gjirokastra dhe përgjigjen e mjeshtrit nga Dibra, punë kjo që fton për të ideuar, shkruar, lexuar, praktikuar të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.

Që nxënësit të drejtohen më lehtë për nga detyra, mësimdhënësi mund të ketë paracaktuar kryet e letrave:

### Letra ndihmëse:

"I nderuar Z. Bajrami,  
Kjo letër porosi vjen ..."

"I dashur Z. Babameto,  
Po ju shkruajmë si përgjigje  
e ...."



Nëse si material bazë keni përzgjedhur një tekst të dhënë apo një fragment nga ndonjë tekst i njohur dramatik, atëherë me këto pyetje mund të nisni zgjerimin e fushës së eksplorimit:

- > Kush merr pjesë në këtë ngjarje?
- > Çfarë ka ndodhur deri më tani?
- > Kur dhe ku po zhvillohet ngjarja?
- > Cili është problemi kryesor rreth të cilit do të përqendrohet eksplorimi dramatik?

Nëse do të vendosni të nisni tregimin me ekspozimin e një një objekt, p.sh. një karrige në muze, atëherë mësimdhënësi do ta fillonte orën duke i ftuar nxënësit për të vëzhguar objektin e vendosur në një hapësirë dhe rrethuar me litar apo shirit dhe do të fillonte eksplorimi me leximin e tabelës shoqëruese për të zbuluar, cilës periudhë i përket, cilës zonë, kush mund ta kishte pasur, etj.

Nëse do të vendosni që tregimi do të nisë me një detaj nga kostumi që mbante Ali Pasha në dasmën e vajzës së Tregtarit dhe që i kishte rënë në shpinës e karriges gjatë mbrëmjes, zbulimi do të niste me mëngjesin e ditës ku familjarët e Tregtarit do të përpiqeshin të gjenin e kujt ishte dhe çfarë mund të kishte në xhepa.

Nëse do të vendosni të përfshini edhe kompetencën digjitale, atëherë përdorimi i video-projektorit është edhe teknika më e përdorshme aktualisht, por jo e vetmja.

Këto janë vetëm disa sugjerime të para, sepse mund të ketë një mori përzgjedhjesh nga e cila mësuesi do të vendosë atë që i përshtatet më mirë me orën mësimore.



## Drama dhe historia

### Tema:

Shqiptarët në fundin e shekullit XIV deri në fillimin e shek. XX, - Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shekujt XVI–XVIII) dhe Pashallëku i Janinës (1787–1822)

**Kompetencat:** zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar njohuritë historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë; Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror; Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë; Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme;

### Teknika e dramës:

Karrigia e nxehtë.

| Kompetencat kyçe:                               | Kompetencat e historisë:                 |
|---|--|
| Komunikimi dhe të shprehurit                    | Analiza shkak – pasojë                   |
| Kompetenca e të menduarit                       | Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën |
| Kompetenca e të mësuarit për të nxënë           | Përdorimi i burimeve                     |
| Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin |  |
| Kompetenca qytetare;                            |  |
| Kompetenca personale.                           |  |



Përsëri jemi me tregimin 'Karriget prej Druri'. Mësimdhënësi u thotë nxënësve se atë orë mësimi Do Të BËJNË së bashku një tregim. Tregimi bën fjalë për një ngjarje të ndodhur në shek.XIX me një pasunari nga Gjirokastra dhe një Mjeshtër druri nga Dibra. Lexohet tregimi dhe përsëri me pyetjet 'Si?' dhe 'Pse?' nis eksplorimi, por këtë radhë mbi çështjet historike.

- Si ishte jeta për shqiptarët në territorin e Dibrës gjatë kohës së sundimit osman?
- Si ishte jeta për shqiptarët në Pashallëkun e Janinës?
- A mundet Ali Pasha të ndërhyjë nëse i pëlqejnë karriget për të ndryshuar rregullin e taksave për punishten e tij?
- Si do ta mundësonte lejen për të transportuar mallin nga Dibra në Gjirokastrë?

Punë në grupe mund të ndahet me detyrat për përcaktimin e figurave kryesore pra, Tregtarit-Blerësit dhe Mjeshtër të Drurit -Shitësit. Dy grupe do të prezantojnë me dy figurat kryesore: si janë, si flasin, si lëvizin, si e përdorin mimikën e gjestin e deri tek fjalët e para që mund të thonë. Secili grup do të përshkruajë se si ka mund të jetë jeta për secilin prej personazheve, pra jeta e një pasunari në Gjirokastrën e viteve 1780-1822, pjesë e së cilës ishte edhe koha kur Ali Pasha e sundoi edhe Gjirokastrën dhe një pjesë të pasunarëve të vendit i internoi që të fuqizonte sundimin e vet; dhe jeta e një mjeshtri druri në Dibër që punonte me rreth 4-5 punëtorë të tjerë, por që fama e punëve të tija ishte e gjerë dhe e kërkuar. Për realizimin e kësaj detyre nxënësit udhëzohen me veprimtarinë "leximi i drejtuar" duke u ndarë në nën-grupe me nga një pyetje secilit dhe një kohë të përcaktuar për lexim e diskutim mbi zhvillimin social dhe ekonomik të dy zonave, Dibër dhe Gjirokastrë. Përveç materialeve mësimore, mund të jepet edhe një libër si material burimor për të lexuar – p.sh. 'Studime Shqiptare' nga Johan George von Hahn.

Mund të përdoret një fazë lidhëse me teknikën 'Tabloja/Imazhi', me ndërtimin e dy tablove një nga Gjirokastra dhe një nga Dibra si në sugjerimin e gjuhës dhe më pas të kalohet tek teknika 'Karrigia e nxehtë'.

Mund të ndajmë klasën në dy grupe: grupi i parë do t'i drejtojë pyetje tregtarit nga Gjirokastra që do të ulet në 'Karrigen e nxehtë' dhe që në dramë është përcaktuar si 'Klienti', ndërsa grupi i dytë do të drejtojë pyetje për mjeshtër nga Dibra që do të ulet në 'Karrigen e nxehtë', i përcaktuar në dramë si 'Shitësi'.

### Grupi 1 - "Klienti" ulet në karrige përballë klasës

Personi që merret në pyetje duhet të përgjigjet në përputhje me atë që ai tashmë di për karakterin, por nëse një pyetje kërkon më shumë informacion, personi thjesht mund të përdorë imagjinatën e tij / saj për të thelluar karakterin. Ja disa informacione shtesë nga një pjesë e shkëputur nga libri 'Studime Shqiptare' që ka informacione për 1812, vitin kur Ali Pasha Tepelena e 'shtiu në dorë' Gjirokastrën.



'Gjirokastra. Ky qytet në kohën të maparshme ka qenë një lloj republike aristokrate, feudalët e të cilit i bindesin deri diku pashës së Delvinës, se me këtë që lidhë Gjirokastra. Në qoftë se prestigji i pashës mbështetej mbi pasurinë e tij dhe ai ishte burrë energjik, atëherë feudalët e Gjirokastrës i nënshtroheshin vullnetit të tij. Por në qoftë se guvernatori i Sulltanit nuk kishte as pasuni, as zotësi, atëherë nuk çante kryet njeri për të dhe ata banin ashtu si u pëlqente. Por prestigji i guvernatorit të vendit, qoftë kur ziheshin shoq me shoq, qoftë kur merrnin gjakun e trashëguem nga etnit, nuk ndjehej kush e di çfarë....'

Me gjithë këto ngatërresa të brendshme, ndër të gjitha viset e Epirit, Gjirokastra i kundërshtoi ma shumë Ali Pashës dhe vetëm më 1812 ai muji me e shtie në dorë. Shumë ma përpara pat ndërtue një kala mbi një kodër në fushën përballë qytetit, ushtarët e të cilës i mundonin gjirokastritët...

Me të marrun në dorë qytetin, Ali Pasha filloi me e forcue pozitën e vet. Shumë familje gna paria e qytetit u internoan në vende të largëta dhe u detyruan me ndërrue toka me ato të pronarëve të tjerë, gja që i dëmtoi mjaft ekonomiksht.'

'(Johan Georg van Hahn - Fq.79 – 80, 2007)

Pyetje të mundshme:

- A ka interes porosia që sapo të ka ardhur?
- Ku i paguan taksat ti për punishten tënde?
- A ke besim se ke njerëz mjaftueshëm për t'ia dalë mbanë në kohë e duhur?
- Çfarë mundësie do të japë kjo punë në raport me punë të tjera në sezonin e ri në Greqi ose Turqi?
- Materialet duhet t'i blesh me para në dorë, apo i paguan kur të ketë mbaruar puna?
- A mund të shpëtosh ndonjë taksë, nëse merret vesh se po bën karrige për Ali Pashë Tepelenën?

Pyetje të mundshme:

- Sa i sigurt je që edhe nëse Ali Pasha Tepelena vjen në dasëm, ti do t'i shpëtosh internimit?
- Sa shërbëtorë ke dhe nëse Ali Pasha ta kërkon a do të vihesh bashkë me ta në shërbim të luftës?
- Deri në sa para ke ndër mend të shpenzosh për karriget e çiftit, po të Ali Pashës?
- Modelin e do me elementë nga tradita shqiptare apo e huaj, apo kombinim?
- Pas dasmës a do të pësojë ngritje tregtia jote?

### Grupi 2 - Ulet në karrigen e nxehtë Shitësi

Përsëri nga burimet shtesë kemi informacion se ustallarët (hem muratorë, hem marangozë), të Shqipnis së Mesme e sidomos të Kolonjës e Dibrës, bajnë mure ose presin dru, në Turqinë Evropiane ose në Mbretërinë e Greqisë. Këta zejtarë punojnë së bashku; ata udhëtojnë bashkarisht nën kryesinë e një mjeshtri të vjetër dhe e transportojnë materialin e duhur me anë të kafshëve. Ata kthehen thuhet se shkojnë në Shënmitër dhe kthehen në Shëngjergj në banimet e tyre se kështu mund të ruajnë shëndetin, në qoftë se verën e kalojnë në ajrin e pastër të maleve të tyre, sepse në Greqi, Tesali e Maqedoni ka pak vende që janë të shëndetshme në verë.' (po aty) Pra, pasi të kemi biseduar me klasën për kushtet në të cilat jetonin mjeshtër të drurit në periudhën otomane, ato informacione do të shërbenin për të krijuar ngjarjet në punishten e drurit.





## Drama dhe një propozim ndërlëndor

### Histori, Gjuhë, Qytetari

Ky model ore mësimore mes dramës është i fokusuar në çështjet morale dhe shoqërore të vendosura në një kontekst historik që e përmban plani mësimor. Mes këtij tregimi bërthamë mund të krijohen mundësi të shumta për zhvillim gjuhësor, njohuri nga historia dhe prezantim i tipareve të jetës shoqërore e kulturore që përmban qytetaria, duke përdorur imagjinatën për të kuptuar përvojat e njerzve të një kohe tjetër.

### Tema ndërlëndore:

- Teksti paraqitës, porosites, etj. Llojet e teksteve
- Rregullat në punës
- Përdorimi i aftësive të komunikimit, punës në grup, etj., për të prezantuar idetë e tij
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar
- Të interpretuarit e teksteve dhe formave të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik
- Të analizuarit dhe interpretuarit e organizimit të familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhës së përcaktuar

### Kompetencat

Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave; përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën; përdor folklorin si burim historik;

Kjo orë mësimore mund të nisë gjithashtu me punë në grupe dhe secilit grup i përcaktohet detyra në lidhje me njohuritë që do të duhet në ndërtimin e skenave me teknikën e 'sajimit'. P.sh: Mblidh të dhëna për organizimin familjar ndër shqiptarë në kohën e pushtimit ottoman; Mblidh të dhëna për kushtet ekonomike të zejtarëve në atë periudhë dhe të tregtarëve të mëdhenj. Pas kohës që u lihet detyrë të mbledhin informacionet, secili grup i prezanton ato për grupin tjetër, e më pas nis puna për përgatitjen e skenave.

### Teknika e dramës: Sajimi

Në këtë grup, mësimdhënësi mund t'i ndajë nxënësit në dy grupe me nga një skenë 3-4 minuta secili, në të cilat do të eksplorohet puna e mjeshtrave për përgatitjen e karrigeve dhe organizimet në shtëpinë e Tregtarit.



Koha



Vendi



Problemet me të cilat ballafaqohen



Cilët personazhe do të bëjë secili nga nxënësit

Skena e grupit të parë mund të nisë me punëtorët duke punuar dhe mjeshtrin që i mbledh për të parë si ka ecur puna dhe a janë në rregull me kohën e mbarimit. Njeri prej punëtorëve këndon lehtë duke punuar një këngë nga folklori i Dibrës i asaj periudhe, ndërsa për krijimin e dialogut mes tyre përdoren të gjitha njohuritë e mbledhura më parë që janë marrë nga mësimi dhe burime të tjera.

Skena e grupit të dytë mund të nisë me babain që i jep lajmin vajzës për martesën (sigurisht që ajo nuk pyetet për këtë vendim) dhe të dy prindërit që thërrasin shërbëtorët për t'ia nisur përgatitjeve, apo për të parë se sa mund të kushtojë dasma, etj.









# DRAMA NË KLASË

TË MËSUARIT PËRMES IMAGJINATËS

---

## Le të mbetemi në kontakt!

 [www.aftesiperpune.al](http://www.aftesiperpune.al)

 [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)

 [skills\\_for\\_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 Skills for Jobs Albania

 Aftësi për Punë S4J